



Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri

**Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe
Perceptimet e Profesionistëve,
Prindërve dhe Fëmijëve.**



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijët në mbarë botën tdh.ch

Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri

**Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe
Perceptimet e Profesionistëve, Prindërve
dhe Fëmijëve.**

Dhjetor 2015

Autorët:

Prof. Genc Burazeri, PhD

Ass. Prof. Gentiana Qirjako Çela, PhD

Izela Tahsini, PhD

Rishikimi Teknik

Enkelejda Bregu Lopari, MBA, MA

Disenjimi & Faqosja

Eduart Strazimiri

Përmbajtja.

Përmbajtja	3
Mirënjohje	5
Përmbledhje	6
Hyrje	9
Përkufizime Konceptuale të Keqtrajtimit të Fëmijëve	9
I. Qëllimi, Objektivat dhe Metodologjia e Studimit	12
Qëllimi i Studimit	12
Metodologjia e Studimit	12
II. Vështrim i Përgjithshëm: Kuadri Normativ dhe Situata Aktuale	14
2.1 Kuadri Ligjor	14
2.2 Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri dhe Menaxhimi i Rasteve të Abuzimit Seksual	16
2.3 Të Dhënat Ekzistuese mbi Situatën e Abuzimit Seksual ndaj Fëmijëve në Shqipëri	17
III. Gjetjet e Studimit	20
3.1 Perceptime të Përgjithshme mbi Abuzimin Seksual të Fëmijëve në Rrethin e Besimit	20
3.2 Karakteristikat “Sasiore” të Rasteve të Abuzimit Seksual ndaj Fëmijëve në Shqipëri	21
3.3 Normat Shoqërore mbi Abuzimin Seksual të Fëmijëve Brenda Rrethit të Besimit në Shqipëri	22
3.4 Parandalimi dhe Mbrojtja e Fëmijëve nga Abuzimi Seksual në Rrethin e Besimit	25
Çështje Strukturore të Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri	31
3.5 Gjetje nga Analiza e Rasteve Studimore: Menaxhimi i Rasteve të Fëmijëve Viktima të Abuzimit Seksual	33
3.6 Roli dhe Ndikimi i Medias në Fenomenin e Abuzimit Seksual të Fëmijëve në Shqipëri	35
Prezantimi në Media i Rasteve të Abuzimit Seksual të Fëmijëve	35
Shkaqet e Pasqyritit Problematik nga Gazetarët	38
Ndikimi i Medias	40

IV. Përfundime dhe Rekomandime	42
4.1 Përfundimet Kryesore të Studimit	42
Fenomeni i Abuzimit Seksual të Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri	42
Normat Sociale dhe Roli i Medias	43
Përgjigjja e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve ndaj Abuzimit Seksual në Rrethin e Besimit	44
4.2 Rekomandimet	47
Shtojcat	51
Shtojca 1: Përbërja e Fokus-grupeve, Instrumentet e Përdorur Gjatë Fokus grupeve dhe Intervistave dhe Analiza e të Dhënave	51
Realizimi i fokus-grupeve për të përftuar (ndriçuar) perspektivën shoqërore të fenomenit të abuzimit seksual ndaj fëmijëve në Shqipëri	51
Formulari i të dhënave statistikore për agjencitë dhe organizatat përgjegjëse për menaxhimin dhe trajtimin e rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve	53
Protokolli i fokus grupeve me profesionistët që merren me mbrojtjen e fëmijëve të dhunuar	54
Protokolli i fokus grupeve me mediat	56
Protokolli i fokus grupeve me prindërit jo-abuzues të fëmijëve të dhunuar	59
Protokolli i fokus grupeve me prindërit vulnerabël	61
Protokolli i fokus grupeve me të rinjtë që në fëmijëri kanë qenë viktime të dhunës seksuale në rrethin e besimit	63
Protokolli i fokus grupeve me të rinjtë vulnerabël	66
Analiza e të dhënave	68
Shtojca 2: Të Dhënat “Sasiore” nga Burimet Administrative Zyrtare	70
Numri i fëmijëve të dhunuar në tërësi dhe abuzimit seksual në veçanti	70
Numri i rasteve të abuzimit seksual sipas vërtetimit të akuzës, grup-moshës së fëmijëve dhe gravitetit të episodeve	74
Numri i rasteve të abuzimit seksual sipas karakteristikave të fëmijëve dhe agresorëve	78
Numri i rasteve të abuzimit seksual sipas autorësisë, dënimit të agresorëve, shërbimeve të ofruara dhe karakteristikave të menaxhimit të rasteve	82
Referencat	87

Mirënjohje.

Autorët e këtij raporti falënderojnë USAID për mbështetjen financiare të këtij studimi shumë të rëndësishëm për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual në rrethin e besimit.

Gjithashtu, falënderime të sinqerta për organizatën Terre des hommes dhe Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, për udhëheqjen, mbështetjen teknike, logjistike dhe veçanërisht gjatë fazës së rishikimit të raportit, me qëllim përmirësimin e tij.

Mirënjohje e veçantë për Z. George Nikolaidis i cili ofroi ekspertizën e tij shumë të vlefshme në skicimin e studimit, hartimin e protokollit dhe përpilimin e instrumenteve të studimit.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, falënderime të veçanta për të gjithë pjesëmarrësit në studim, si institucionet që ofruan të dhënat e tyre administrative në kuadrin e këtij punimi, profesionistët e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe përfaqësuesve të medias.

Mbi të gjitha, autorët i janë mirënjohës fëmijëve dhe prindërve të tyre që ndanë me ne historinë dhe përvojën e tyre në procesin e gjatë të shërimit dhe të riintegritimit nga trauma, si dhe aspiratat e tyre për të ardhmen.

Përmbledhje.

Në Shqipëri, ka shumë pak studime që trajtojnë çështje të abuzimit ndaj fëmijëve, veçanërisht çështje të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit. Abuzimi seksual në rrethin e besimit (*dhunimi seksual i fëmijëve nga një ose disa persona të njohur dhe të besuar të cilët kanë autoritet dhe influencë tek fëmijët, përfshi këtu edhe personat brenda familjes*), edhe pse relativisht i shpeshtë, është shumë i vështirë për t'u identifikuar, analizuar dhe më pas adresuar nëpërmjet programeve dhe shërbimeve efektive.

Studimi mbi *Abuzimin Seksual të Fëmijëve Brenda Rrethit të Besimit*, i cili u realizua në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, i përgjigjet nevojave të institucioneve për të hedhur dritë mbi një fenomen i cili ka vëmendjen e tyre dhe kërkon ndërhyrje dhe politika të veçanta. Ai u krye në kuadër të përpjekjeve për të forcuar sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri. Gjithashtu studimi i përgjigjet nevojës për monitorimin e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e Lanzarotës, dhe veçanërisht të raundit të parë të monitorimit, i cili ka në fokus kuadrin ligjor lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit.

Në këtë kontekst, studimi u orientua drejt veprimtarive dhe masave konkrete ndaj abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të tyre të besimit, me një fokus kryesor mbi karakteristikat dhe normat shoqërore që ndikojnë tek ky fenomen në Shqipëri, në mënyrë që të hartohen politika dhe të zbatohen programe e shërbime efektive parandaluese dhe trajtuese, si dhe të forcohen në tërësi kapacitetet e sistemit të mbrojtjes dhe ofrimit të shërbimeve ndaj fëmijëve të dhunuar në vendin tonë.

Studimi u realizua gjatë periudhës Gusht-Tetor 2015 në Shqipëri në rrethet Tiranë, Shkodër, Korçë, Fier dhe Elbasan. Ai ishte kryesisht i tipit *kualitativ (cilësor)* dhe konsistoi në komponentët e mëposhtme: **(i)** diskutime në fokus-grupe; **(ii)** intervista të thelluara, dhe; **(iii)** studime rastesh konkrete të fëmijëve viktime të abuzimit seksual në rrethin e besimit.

Të gjithë pjesëmarrësit e studimit u informuan qartë lidhur me qëllimin dhe objektivat e studimit. Pjesëmarrësve iu sqaruan me hollësi të gjitha aspektet dhe procedurat e studimit, veçanërisht aspektet e lidhura me *anonimin* dhe *konfidencialitetin* e studimit. Në asnjë rast, të dhënat nuk u përdorën për të identifikuar pjesëmarrësit.

Gjetjet kryesore të këtij studimi mund të përmbledhen shkurtimisht në çështjet e mëposhtme:

- Në pjesën më të madhe të tyre, profesionistët pjesëmarrës në këtë studim u shprehën se *abuzimi seksual i fëmijëve ndodh kryesisht brenda rrethit të tyre të besimit*. Përgjithësisht profesionistët mendonin se abuzimi seksual i fëmijëve brenda rrethit të besimit mund të ndodhë tek çdo fëmijë, pavarësisht moshës, gjinisë, gjendjes social-ekonomike, arsimimit, etj.
- *Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët nga shtresa në nevojë* u konsideruan si grupet më të brishta, tek të cilët mund të hasen me shpesh forma të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit.
- Studimi tregoi se në përgjithësi, *mungojnë të dhënat sistematike dhe koherente* sa i përket rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht dhe në veçanti të atyre brenda rrethit të besimit. Problematikat mbi regjistrimin e rasteve lidhen me mungesën e indikatorëve

të unifikuar mbarëkombëtarë, mungesën e një sistemi të standardizuar të monitorimit të rasteve dhe faktin se struktura të ndryshme kanë databaza të ndryshme.

- *Normat sociale dhe qëndrimet* tolerante në përgjithësi ndaj dhunës, ruajtja e sekretit familjar që vlerëson si të shenjtë privatësinë e familjes, ushqen sekretin dhe heshtjen, si edhe stigmatizimi i fëmijëve viktime të abuzimit seksual në shoqëri bën që profesionistët, prindërit dhe fëmijët të hezitojnë ta raportojnë atë.
- *Mangësi në raportim nga profesionistët si pasojë e pasigurisë.* Një pjesë e madhe e profesionistëve të përfshirë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve të abuzuar seksualisht brenda rrethit të tyre të besimit u shprehën se nuk ndihen të sigurt dhe se marrin shpesh kërcënime nga abuzuesit apo familjarët e tyre, çka i bën ata të heqin dorë nga raportimi i rasteve. Rrjedhja e informacionit (humbja e konfidencialitetit), raportimi i papërshtatshëm në media dhe stigmatizimi i viktimës shfaqen si arsye kryesore të mos-denoncimit të rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht brenda rrethit të tyre të besimit.
- *Mungesa e masave parandaluese* për ndërgjegjësimin dhe informimin e të gjithë aktorëve që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët, duke filluar nga prindërit dhe familja, mbi ekzistencën e abuzimit seksual të fëmijëve në rrethin e besimit.
- *Ndihma afatgjatë dhe rehabilitimi.* Pas kapërcimit të fazës emergjente, fëmijët e abuzuar seksualisht, por edhe familjarët e tyre mbeten në situatë të vështirë dhe me shumë nevoja të paplotësuar. Kështu, nevojat ekonomike, nevojat për mbështetje psikologjike dhe siguri plotësohen vetëm minimalisht nga sistemi i mbrojtjes së fëmijës. Profesionistët konstatojnë mungesën e shërbimeve mbështetëse dhe atyre të specializuara për fëmijët e abuzuar seksualisht dhe familjarët e tyre.
- *Shkelja e etikës nga media dhe mungesa e monitorimit dhe e ndëshkimit.* Shpeshherë, viktimat identifikohen lehtësisht nëpërmjet medias. Kodi etik i gazetarëve duket se nuk konsiston aktualisht në ndonjë standard lidhur me raportimin e lajmit. Për më tepër, kodi etik i gazetarëve nuk monitorohet dhe nuk ka penalizime për moszbatimin e tij.

Bazuar në rezultatet e këtij studimi, më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur disa rekomandime kryesore lidhur me çështjet prioritare për reformat e politikave sociale në Shqipëri:

- *Ofrimi i shërbimeve parandaluese me bazë komunitare:* (i) ngritja e shërbimeve komunitare më qëllim ofrimin e shërbimeve parandaluese, ndërgjegjësuere dhe rritjen e sensibilizimit të shoqërisë dhe vetë fëmijëve, prindërve dhe profesionistëve në mënyrë që të ndërhyhet para se abuzimi të ndodhë; (ii) nëpërmjet fushatave kombëtare, ku media konsiderohet si një partner shumë i rëndësishëm, mund të rriten ndërhyrjet në komunitet për të modifikuar normat sociale që influencojnë abuzimin seksual të fëmijëve (si rritja e sensibilitetit dhe empatisë për viktimat e abuzimit, rritja e ndërgjegjësimin për nivelin e dhunës dhe impaktin e saj shoqëror); (iii) programet e fokusuar në mirë-funksionimin e familjes dhe praktikave prindërore kanë rezultuar të suksesshme në shumë vende lidhur me reduktimin e abuzimit seksual të fëmijëve. Këto programe synojnë të ndërgjegjësojnë prindërit dhe vetë fëmijët mbi rrezikun që ekziston brenda rrethit të tyre të besimit si dhe të aftësojnë fëmijët mbi mënyrat e mbrojtjes në situata rreziku.
- *Përmirësimi i kurrikulave shkollorë:* aktualisht, kurrikulat ekzistuese nuk trajtojnë çështje të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të tyre të besimit. Meqenëse abuzimi seksual i fëmijëve ndodh kryesisht brenda rrethit të tyre të besimit, lind nevoja urgjente të ndërhyhet menjëherë për përmirësimin e kurrikulave shkollorë.
- *Ngritja e shërbimeve mbështetëse, të specializuara dhe që shmangin abuzimin dytësor për viktimat dhe familjarët e tyre:* (i) ngritja e shërbimeve të specializuara në formën e qendrave “Barnahouse” për fëmijët e abuzuar seksualisht; (ii) ofrimi i shërbimeve mbështetëse afatgjata për fëmijët e abuzuar dhe për familjarët e tyre, shërbime të cilat duhet të jenë të aksesueshme për të gjitha shtresat e popullatës.

- *Forcimi i shërbimeve dhe kapaciteteve profesionale që punojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve: (i)* përmirësimi i mjediseve të posaçme të trajtimit për fëmijët e abuzuar seksualisht (sidomos në polici dhe në sektorin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore); *(ii)* rritja e numrit të psikologëve pranë organeve të rendit (policisë) dhe në shkolla; *(iii)* trajnimi adekuat për të gjithë profesionistët që ofrojnë shërbime të specializuara (punonjës social, policë, prokurorë, gjykatës, mjekë, psikologë, mësues);
- *Përmirësimi i kuadrit ligjor: (i)* ndryshime ligjore lidhur me të drejtën që duhet të ketë policia për fillimin e investigimit në rastet e dyshuara, pa pritur që të bëhet denoncimi i rastit; *(ii)* krijimi i një hapësire ligjore për ofrimin e shërbimit psikologjik të specializuar dhe falas për fëmijët e abuzuar seksualisht dhe familjarët e tyre; *(iii)* trajtimi i detyruar psikologjik i autorëve të krimit; *(iv)* rishikimi i detyrave të profesionistëve për të pasur detyrimin që të mbajnë në vëzhgim faktin që autorët të përshirë në abuzimin seksual të fëmijëve të mos mund të punojnë në mjedise me fëmijë pasi kanë shlyer dënimin.
- *Përmirësimi i sistemit të informacionit mbi abuzimin seksual tek fëmijët:* ngritja e një sistemi të dhënash në nivel kombëtar, ku të gjitha institucionet të mbledhin të dhënat sipas të njëjtit sistem lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve për të siguruar informacion mbi shkallën e problemit të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të tyre të besimit duke ndihmuar në hartimin e programeve parandaluese dhe të ndërhyrjes të bazuara në evidenca.

Hyrje.

Mbrojtja e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit është një e drejtë themelore e të gjithë fëmijëve, prandaj institucionet shtetërore dhe ato publike, shoqëria civile, komunitetet dhe familja kanë detyrimin të krijojnë një mjedis që edukon, mbron dhe kujdeset për të gjithë fëmijët e një vendi.

Reduktimi dhe zbutja e dhunës ndaj fëmijëve me synim final eliminimin e saj është një nga qëllimet më të rëndësishme të strategjive dhe programeve sociale në të gjitha vendet e rajonit evropian në përputhje me përbushjen e objektivave të "Shëndetit 2020".

Dhuna dhe abuzimi ndaj fëmijëve janë të pranishme në të gjitha vendet e botës dhe janë produkt kompleks i shumë faktorëve shoqërorë, kulturorë, ekonomikë dhe biologjikë.

Për më tepër, dhuna dhe keqtrajtimi i fëmijëve përbën faktorin kryesor të pabarazive shëndetësore dhe padrejtësive shoqërore, ku grupet social-ekonomike vulnerabël janë edhe në risk më të lartë për të pësuar eksperiencë të tilla negative¹.

Përkufizime Konceptuale të Keqtrajtimit të Fëmijëve.

Keqtrajtimi i Fëmijëve

Keqtrajtimi i fëmijëve përkufizohet si:

"Të gjitha format a keqtrajtimit fizik dhe emocional, abuzimi seksual, neglizhenca ose shfrytëzimi komercial i fëmijëve, që rezultojnë në dëmtime të gjendjes shëndetësore të fëmijëve, rrezikojnë jetën e tyre, cenojnë zhvillimin ose dinjitetin e fëmijëve në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie ndaj fëmijëve, marrëdhënieje besimi, ose marrëdhënieje autoriteti"^{2,3}

Përkufizimi i abuzimit seksual u formulua në deklaratën e Konsultimit për Parandalimin e Abuzimit ndaj Fëmijëve të OBSH-së në vitin 1999, sipas të cilës:

"Abuzimi seksual i fëmijëve nënkupton përfshirjen e fëmijëve në aktivitete seksuale të cilat ato nuk i kuptojnë plotësisht, ose nuk janë të përgatitur apo të zhvilluar (të rritur) prandaj edhe janë të paafte që të japin miratimin/pëlqimin përkatës, ose aktivitete të cilat bien ndesh me ligjet dhe tabútë e shoqërisë. Dhuna seksuale ndaj fëmijëve evidentohet nga aktivitete të tilla mes fëmijës dhe një personi të rritur, ose një tjetër fëmijë më të rritur i cili ka marrëdhënie besimi, apo pushteti (autoriteti) me fëmijën e dhunuar. Aktivitete të tilla të lidhura me abuzimin seksual të fëmijëve mund të përfshijnë situatat e mëposhtme (listë e cila nuk është aspak shtruesë): Përfshirja e fëmijëve në aktivitete seksuale të paligjshme; Shfrytëzimi i fëmijëve për prostitucion, ose praktika të tjera të paligjshme; Shfrytëzimi i fëmijëve për performanca të ndryshme pornografike."

Konventa e Lanzarotës (2007), është traktati i parë ndërkombëtar që adreson çështjen e abuzimit seksual tek fëmijët brenda rrethit të besimit. Konventa përcakton qartë detyrimin e shteteve palë për të kriminalizuar abuzimin seksual me fëmijët në rrethin e besimit.

Sipas Nenit 18 të Konventës, “Çdo palë merr masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t’u siguruar se sjelljet e mëposhtme, kur kryhen me qëllim, përcaktohen si masa penale:

- b. përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë, në këto situata:
 - kur abuzohet me një pozicion të njohur që gëzon besim, autoritet ose ndikim mbi fëmijët, duke përfshirë edhe marrëdhëniet brenda familjes⁴.

Rrethi i Besimit

Abuzimi seksual në rrethin e besimit i referohet dhunimit seksual të fëmijëve nga një ose disa persona të njohur dhe të besuar të cilët kanë autoritet dhe influencë tek fëmijët, përfshi këtu personat brenda familjes, komshinjtë, persona të njohur në rrethin familjar, mësues, etj.

Nga kjo pikëpamje, marrëdhënie të tilla në “rrethin e besimit” zakonisht ekzistojnë midis fëmijës dhe prindërve të tij, anëtarëve të tjerë të familjes, kujdestarëve ose prindërve adoptues, por ato mund të ekzistojnë gjithashtu edhe në lidhje me personat të cilët:

- kanë funksione prindërore ose të kujdesit, *ose*
- edukojnë fëmijën, *ose*
- ofrojnë kujdes emocional, shpirtëror, terapeutik ose mjekësor, *ose*
- punësojnë ose kanë kontroll financiar mbi fëmijën, *ose*
- ushtrojnë kontroll mbi fëmijën.

Evidenca nga shumë vende të Europës tregojnë se abuzimi seksual i fëmijëve ndodh kryesisht në rrethin familjar, nga persona që janë të afërt me fëmijët, ose nga individë në mjedisin shoqëror të fëmijëve. Sipas artikullit të Këshillit të Europës mbi abuzimin seksual të fëmijëve, forma më e shpeshtë e abuzimit seksual të fëmijëve i atribuohet familjarëve ose të afërmve të fëmijëve viktimë, me rreth 85% të rasteve totale në rrethin e besimit të fëmijëve (Këshilli i Europës, 2007).

Shumica e abuzuesve njihen me viktimën; afërsisht 30% e tyre janë të afërm: më shpesh vëllai, babai, xhaxhai ose kushëri; rreth 60% janë të njohur të tjerë, si “miq të familjes” fqinjë, kujdestarë; dhe vetëm 10% janë të panjohur⁵. Prandaj, abuzimi seksual i fëmijëve në rrethin e besimit konsiderohet mjaft i përhapur pavarësisht nga evidenca e kufizuar zyrtare si pasojë e vështirësive për matjen dhe raportimin e saj.

Gjithsesi, sfidat e lidhura me magnitudën e saktë dhe faktorët shkaktarë pengojnë hartimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve efektive për adresimin adekuat të abuzimit seksual të fëmijëve që përbën edhe një çështje tepër të ndjeshme për çdo shoqëri.

Abuzimi seksual në rrethin e besimit, edhe pse relativisht i shpeshtë, është shumë i vështirë për t’u identifikuar, analizuar dhe më pas adresuar nga programe dhe aktivitete efektive.

Një rishikim shkencor i studimeve epidemiologjike të realizuara në 21 vende, kryesisht shtete me të ardhura të mesme ose të larta, zbuloi se të paktën 7% e femrave (deri në 36% të tyre) dhe 3% e meshkujve (deri në 29% të tyre) raportojnë të kenë qenë viktimë të abuzimit seksual gjatë fëmijërisë së tyre⁶. Sipas këtyre studimeve, 14% deri në 56% e vajzave dhe 25% e djemve të dhunuar seksualisht ishin viktimë të abuzimit nga ana e familjarëve (“të gjakut”), ose njerku (njerkes).

Në shumë vende, të rriturit flasin rreth rrezikut që i kanoset fëmijëve të tyre për abuzim seksual në mjediset e shkollës ose në komunitet, por shumë rrallë flasin rreth rrezikut që i kanoset fëmijëve të tyre në shtëpi, ose në kontekstin e gjerë familjar, ku fëmijët mund të jenë viktimë të abuzimit seksual jo vetëm nga pjesëtarët e familjes, por edhe nga persona të tjerë të afërt si komshinjtë, miq të ndryshëm të familjes, apo mësuesit e tyre. Turpi, fshehtësia dhe mohimi të lidhura me dhunën seksuale ndaj fëmijëve në mjedisin familjar formëzojnë një kulturë të heshtjes, ku fëmijët nuk mund të flasin rreth abuzimeve seksuale të pësuar dhe ku prindërit nuk flasin rreth rrezikut që i kanoset fëmijëve të tyre, ose nuk dinë si të veprojnë në rastet kur dyshojnë që fëmijët e tyre mund të jenë viktimë të abuzimit seksual në kontekstin apo në mjedisin familjar⁶.

Shumica e fëmijëve nuk e raportojnë dhunën seksuale të pësuar në mjedisin familjar sepse ndjehen të frikësuar për pasojat ndaj tyre ose familjarëve të tyre, faktit që familjarët do të turpërohen prej tyre, refuzimin e mundshëm nga familjarët, si dhe faktin që mund të mos besohen për raportimin e tyre⁶.

Edhe të rriturit jo abuzues mund të mos raportojnë dhunën seksuale të ushtruar ndaj fëmijëve të tyre në mjedisin familjar. Në komunitete dhe familje me norma të ngurta patriarkale që lidhen edhe me "nderin" familjar, djemtë që raportojnë eksperiencën të dhunës seksuale mund të shihen si të dobët dhe jo-burrërorë, ndërsa vajzat mund të fajësohen për akte të tilla dhe shpesh mund të rrihen, madje edhe të vriten^{8,9}.

Si djemtë ashtu edhe vajzat janë njëlloj vulnerabël ndaj dhunës seksuale, por krahasimi i të dhënave të studimeve ndërkombëtare dëshmon se niveli i abuzimit seksual ndaj vajzave është më i lartë në krahasim me djemtë^{10,11}.

I. Qëllimi, Objektivat dhe Metodologjia e Studimit.

Qëllimi i Studimit.

Ky studim ka për qëllim të hedhë dritë mbi situatën e abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit në Shqipëri. Ai synon të japë një panoramë të përgjithshme të fenomenit në shoqërinë shqiptare, si dhe të identifikojë format dhe tipologjinë e këtij abuzimi brenda rrethit të besimit, me një fokus kryesor tek normat shoqërore, roli i profesionistëve dhe medias për parandalimin, luftën dhe mbrojtjen e fëmijëve të prekur nga ky fenomen. Më konkretisht ky studim ka këto objektiva specifike:

- Identifikimi i karakteristikave të abuzimit seksual të fëmijëve shqiptarë në rrethin e tyre të besimit.
- Identifikimi i normave shoqërore që ndikojnë në fenomenin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe reagimi ndaj këtij fenomeni në të gjitha hallkat e sistemit, përfshi profesionistët e kësaj fushe në Shqipëri.
- Identifikimi i përgjigjes së sistemit, praktikave dhe shërbimeve ekzistuese lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve shqiptarë në rrethin e tyre të besimit.

Metodologjia e Studimit.

Lloji i Studimit dhe Periudha Kohore

Gjatë periudhës Gusht – Tetor 2015, një studim kryesisht *kualitativ (cilësor)* u realizua në Shqipëri në rrethet: Tiranë, Shkodër, Korçë, Fier dhe Elbasan. Përmes metodave cilësore u hulumtuan perceptimet e profesionistëve nga sektorët kyç të shërbimeve për fëmijët, përfaqësuesve të medias, fëmijëve dhe prindërve të prekur nga fenomeni i abuzimit seksual brenda rrethit të besimit. Qëllimi i këtij studimi nuk është përgjithësimi i gjetjeve, por hulumtimi i thelluar mbi të kuptuarit e përgjithshëm të fenomenit dhe përgjigjen e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nga perspektiva e vetë pjesëmarrësve, për të gjeneruar një të kuptuar të ri, të përbashkët mbi kompleksitetin dhe karakterin shumë dimensional të kësaj çështjeje.

Studimi konsistoi në komponentët e mëposhtme:

- (i) Diskutime në fokus-grupe (me profesionistët nga sektorët kryesorë të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Gjithsej u organizuan 8 fokus grupe me 47 pjesëmarrës, në 4 qarqe të Shqipërisë (2 fokus grupe për secilin qark), respektivisht në Tiranë, Shkodër, Fier dhe Korçë.
- (ii) Fokus grupe me të rinj dhe prindër për të vlerësuar nivelin e përgjigjes së sistemit ndaj rasteve me abuzim seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit. Gjithsej u realizuan dy fokus grupe me prindër vulnerabël (12 pjesëtarë), respektivisht në Fier dhe Tiranë, dhe dy fokus grupe me të rinj (15 të rinj), respektivisht në Korçë dhe Fier.

- (iii) Dy fokus grupe me gazetarë (10 pjesëmarrës) dhe dy fokus grupe të tjera me profesionistë të tjerë (13 pjesëmarrës) për të përshkruar qëndrimet dhe perceptimet mbi normat sociale dhe mbulimin mediatic të rasteve të tilla në Shqipëri. U organizuan gjithsej katër fokus-grupe në Tiranë dhe Elbasan.
- (iv) Intervista të thelluara (me prindërit jo abuzues dhe me fëmijët viktime të abuzimit seksual). Intervistat u zhvilluan me prindër (tre nëna), fëmijët e të cilëve ishin abuzuar seksualisht brenda rrethit të besimit të fëmijëve, dhe me fëmijë (dy fëmijë), viktime të një abuzimi të tillë.
- (v) Studime rastesh konkrete të fëmijëve viktime të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit. Qëllimi i përfshirjes së këtyre rasteve ishte ndriçimi më i thellë dhe më i plotë i të gjitha hallkave të menaxhimit të rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të tyre të besimit. Në total, u përfshinë 30 raste të fëmijëve të abuzuar seksualisht në rrethin e besimit, të dokumentuara përgjatë vitit 2014 dhe 2015 nga organizata Terre des hommes (Tdh). Për secilin rast individual, u aplikua një instrument tip (standard) për ekstraktimin e informacionit specifik të nevojshëm, ashtu siç paraqitet në mënyrë të plotë në pjesën përkatëse të "Shtojcës Nr. 2".

Aspektet Etike të Studimit

Të gjithë pjesëmarrësit e studimit u informuan qartë lidhur me qëllimin dhe objektivat e studimit. Pjesëmarrësve iu sqaruan me hollësi të gjitha aspektet dhe procedurat e studimit, veçanërisht aspektet e lidhura me *anonimatin* dhe *konfidencialitetin* e studimit.

Në asnjë rast, të dhënat nuk u përdorën për të identifikuar pjesëmarrësit. I gjithë informacioni i grumbulluar në kuadrin e këtij studimi iu dorëzua Tdh për ruajtje të mëtejshme.

Instrumentet e Studimit

Një protokoll i detajuar për përmbajtjen dhe strukturën e diskutimeve në fokus-grupe u përgatit paraprakisht dhe më pas ekipi i profesionistëve për mbledhjen e të dhënave u trajnua për moderimin dhe lehtësimin e takimeve përkatëse.

Gjithashtu, profesionistët e mbledhjes së të dhënave në këtë studim u trajnuan edhe për menaxhimin e kohës sipas kategorive përkatëse të individëve të përfshirë në fokus-grupe të ndryshme. Në ato raste ku nuk ishte e mundur që të organizohej një fokus-grup i caktuar, u realizuan intervista të veçanta me persona kyç sipas kategorive përkatëse.

Analiza e të Dhënave

Një analizë e detajuar *kualitative (cilësore)* u ndërмор për identifikimin e karakteristikave të abuzimit seksual ndaj fëmijëve dhe normave shoqërore që ndikojnë në madhësinë, përhapjen dhe faktorët shkaktarë të këtij fenomeni në Shqipëri. Analiza e Përmbajtjes ("*Content Analysis*") u përdor për të analizuar të dhënat e transkripteve. Hapi i parë i analizës ishte leximi i transkripteve disa herë për të nxjerrë një kuptim të përgjithshëm të mesazheve të tekstit. Më pas, u përdor "Teknika e Tavolinës së Gjatë" ("*Long Table*" approach), bazuar kjo në rekomandimet përkatëse të literaturës shkencore bashkëkohore për studime të ngjashme (Krueger & Casey, 2008).

Metodologjia e detajuar e studimit përfshi përbërjen e fokus-grupeve, instrumentet e përdorur gjatë fokus-grupeve dhe intervistave, si dhe strategjia e analizës së të dhënave paraqiten në mënyrë të detajuar në "Shtojcën 1".

II. Vështrim i Përgjithshëm: Kuadri Normativ dhe Situata Aktuale.

2.1 Kuadri Ligjor.

Konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”, e njohur si **Konventa e Lanzarote-s**, 25.10.2007 është dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar i cili ka në fokus abuzimin seksual tek fëmijët. Ajo ka si qëllim të parandalojë dhe të luftojë abuzimin seksual të fëmijëve, të mbrojë të drejtat e fëmijëve viktime të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual, si edhe të nxisë bashkëpunimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve.

Konventa e përcakton abuzimin seksual të fëmijëve (neni 18) si “përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë, i cili, sipas dispozitave të legjislacionit të brendshëm, nuk e ka arritur ende moshën ligjore për aktivitete seksuale”; “përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë kur është përdorur shtrëngimi, forca, kërcënim”; kur “abuzohet me një pozicion të njohur që gëzon besim, autoritet ose ndikimi mbi fëmijën, duke përfshirë edhe marrëdhëniet brenda familjes”; kur “abuzohet në veçanti me situatën karakteristike të brishtë të fëmijëve, kryesisht për shkak të një paaftësie mendore ose fizike ose të një situatë varësie”.

Në të vërtetë, në marrëdhënie të tilla, një i rritur mund të përfitojë nga ndryshimi i moshës dhe marrëdhënia e pushtetit që ka mbi fëmijën, për ta detyruar, bindur ose shtyrë fëmijën të marrë pjesë në aktivitete për të cilat viktime, për shkak të moshës nuk është plotësisht i vetëdijshëm për natyrën dhe pasojat e tyre. Duke përdorur të njëjtin mekanizëm psikologjik nënshtrimi, abuzuesit përdorin kërcënimin dhe e bëjnë fëmijën të ndihet fajtor, që në vetvete e pengon fëmijën të mbrohet dhe të kërkojë ndihmë.

Gjatë dy dekadave të fundit kuadri ligjor për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri ka ardhur duke u përmirësuar, me hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi, përfshi edhe abuzimin seksual. Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim është edhe ratifikimi i Konventës së Lanzarotës me Ligjin Nr. 10071, datë 9.2.2009, proces i cili i mundëson një vendi përafrimin e kuadrit të vet ligjor me parashikimet e konventës. Procese të tilla, përfshijnë në radhë të parë amendime të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale.

Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995 “**Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë**”, në Seksionin VI, Krime Seksuale, përkatësisht në nenet 100 – 108, parashikon vepra penale kundër *dhunës dhe shfrytëzimit seksual ndaj fëmijëve*. Me ndryshimet e fundit të bëra gjatë vitit 2013, me Ligjin Nr. 144/2013, ka një ashpërsim të mëtejshëm të dënimeve penale, kundrejt autorëve të krimeve seksuale kundër fëmijëve.

Sipas këtij kodi, moshë kur një fëmijë mund të japë konsensusin për marrëdhënie seksuale është 14 vjeç (neni 100), ndërsa Neni 101 kriminalizon "marrëdhëniet seksuale me dhunë" me fëmijët 14-18 vjeç me dënim nga 5-15 vjet. Edhe pse përcaktimi me ligj i moshës 14 vjeç për konsensusin për marrëdhënie seksuale është një hap pozitiv në mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi seksual, kjo moshë bie në kundërshtim me Konventën e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe ligjin shqiptar, e cila përcakton se "fëmijë është çdo person deri në moshën 18 vjeç". Gjithashtu këto nene kriminalizojnë aktin e penetrimit seksual, por nuk përcaktojnë qartë veprime të tjera me natyrë seksuale që mund të ndërmerren kundrejt fëmijës. Neni 108 dënon kryerjen e akteve të turpshme në prezencë të fëmijës nën moshën 14 vjeç, por nuk jep një përkufizim të akteve të turpshme. Për më tepër fëmijët mbi moshën 14 vjeç nuk janë të mbrojtur nga ky nen.

Kjo mangësi në legjislacionin shqiptar është evidentuar edhe nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës sipas të cilit "*Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës është thellësisht i shqetësuar për gjendjen e legjislacionit shqiptar, i cili nuk mbron të gjithë fëmijët deri në moshën 18-vjeçare nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, për mungesën e masave efektive për parandalimin dhe luftimin e tij, si dhe mungesën e shërbimeve për t'i ofruar fëmijëve mbështetje psiko-sociale, rehabilitim dhe ri-integrim*".

Lidhur me abuzimin seksual brenda rrethit të besimit, Kodi Penal parashikon dënime penale në rastet e abuzimit seksual *duke shpërdoruar marrëdhëniet e varësisë ose të detyrës* (neni 105) apo me *persona në gjini ose nën kujdestari* (neni 106). Megjithatë vihet re se këto nene ende nuk marrin parasysh të gjithë dimensionin e marrëdhënies së besimit siç përcaktohet edhe nga Konventa e Lanzarotës. Sipas Raportit të Parë të Monitorimit të Zbatimit të Konventës së Lanzarotës (Lanzarote Committee 2015), "*një pjesë e shteteve anëtare kanë futur në legjislacionin e tyre dënimin penal për abuzimin seksual të fëmijëve në kontekstin e abuzimit me pozitën, statusin ose marrëdhënien, por vetëm një prej tyre ka përdorur terminologjinë e përcaktuar në Konventën e Lanzarotës për përcaktimin e kimit si abuzim në një pozitë besimi, autoriteti ose ndikimi mbi fëmijën, duke përfshirë edhe marrëdhëniet brenda familjes*". Monitorimi i zbatimit të Konventës së Lanzarotës tregon se përcaktimi më i saktë i kimit të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit, duke e përafëruar atë me përcaktimin e Konventës së Lanzarotës është i domosdoshëm. Gjithashtu, ky përcaktim duhet të përfshijë të gjithë personat e mundshëm që mund të abuzojnë me pozitën e tyre të besimit, autoritetit ose të ndikimit (si p.sh rrethi shoqëror i anëtarëve të familjes, një fqinj, etj.).

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri garantohej nëpërmjet Ligjit Nr. 10 347 "**Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve**", i miratuar në 4.11.2010. Ligji përfshin të drejtat e fëmijëve dhe mekanizmat shtetërorë institucionalë që mundësojnë observimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave. Abuzimi dhe shfrytëzimi seksual është një nga format e dhunës të përmendura në këtë ligj (neni 21 dhe 24). Ky ligj jep përkufizimet e prostitucionit të fëmijës, pornografisë dhe shitjes së fëmijëve, por ai nuk përkufizon se çfarë quhet dhunë seksuale dhe nuk parashikon masa mbrojtëse të veçanta për fëmijët e abuzuar seksualisht.

Ligji Nr. 9669 datë 18.12.2006 "**Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare**" synon parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë *fëmijëve*, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Ky ligj, përcakton për herë të parë masa mbrojtëse për viktimën nëpërmjet dy instrumenteve kryesore, "*Urdhrit të Mbrojtjes*" dhe "*Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes*", të cilët lëshohen nga gjykata, i cili parashikon edhe mundësinë e largimit të autorit të supozuar të aktit ose të viktimës nga mjedisi i tij/saj familjar. Sipas raportit të Komitetit të Lanzarotës, Shqipëria duhet t'i bëjë referencë specifike në këtë ligj abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit që të garantohej mbrojtja e nevojshme nga abuzimi seksual brenda rrethit të besimit.

Edhe pse Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Lanzarotës, si dhe atë të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, legjislacioni shqiptar ka ende sfida sa i përket çështjes së mbrojtjes së fëmijës, dhe në veçanti mbrojtjes së fëmijës nga abuzimi seksual. Pa dyshim, njohuria për fenomenin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve vjen në rritje dhe bashkë me rritjen e të kuptuarit të përbashkët mbi karakteristikat dhe tipologjinë e fenomenit, lind edhe nevoja për rishikime të vazhdueshme të legjislacionit. Ky raport evidenton nevojën për një analizë më të thelluar të kuadrit ligjor për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, e cila duhet të evidentojë mangësitë dhe nevojën për përmirësime ligjore, si dhe të përbëjë një bazë të vlefshme për hartimin e ligjeve dhe akteve nën ligjore të reja, politikave dhe ndërhyrjeve për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual.

2.2 Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri.

Ligji Nr. 10347 “**Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve**”, parashikon ngritjen e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF) brenda strukturës së njesisë administrative vendore, si e vetmja strukturë e specializuar në nivel vendor që koordinon parandalimin, mbrojtjen dhe referimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në territorin e vet përmes qasjes shumë-sektoriale të menaxhimit të rastit. Ky ligj dhe aktet e tij normative, përcaktojnë se përgjegjësia e kujdesit dhe e mbrojtjes së fëmijës nuk është vetëm e NJMF-së, por e të gjithëve aktorëve publikë dhe jo-publikë që kanë një rol në ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nivel vendor, rajonal dhe qendror.

Udhëzimi Nr. 10, datë 25.02.2015 “*Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës*”, përcakton hapat e procesit për menaxhimin e rastit, që ndiqen nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës (PMF), ose nga çdo punonjës social pranë institucioneve të tjera që menaxhon një rast të mbrojtjes së fëmijës.

Nga raportet dhe analizat e bëra deri tani¹², sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri ka shumë mangësi, sidomos sa i përket nivelit të kapaciteteve të profesionistëve për t’ju përgjigjur nevojave komplekse të fëmijëve të abuzuar dhe familjeve të tyre, mungesës së buxhetit dhe mungesës së shërbimeve mbështetëse rehabilituese dhe ri-integruese për fëmijën dhe familjen.

Neni 14/1 i Konventës së Lanzarotës përcakton “Çdo palë merr masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të ndihmuar viktimat, në kuadrin *afatshkurtër dhe afatgjatë, për rimëkëmbjen e tyre fizike dhe psikosociale. Masat e marra në përputhje me këtë paragraf duhet të marrin parasysh pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e fëmijëve*”.

Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri i mungojnë shërbimet e emergjencës 24 orë (përveç një qendre në Tiranë), si edhe shërbimet e specializuara për fëmijët e abuzuar seksualisht dhe autorët e krimit, të cilat do mundësonin ofrimin e ndërhyrjes së menjëhershme dhe trajtimit afatgjatë të fëmijës dhe familjes sipas një modeli ekologjik.

Disa praktika premtuese*

Në Islandë, Shtëpia e Fëmijëve/Barnahus është një qendër multidisiplinare, shumë sektoriale dhe miqësore për fëmijët ku profesionistë të shumtë punojnë nën të njëjtën çati, hetojnë raste të dyshuara të abuzimit seksual të fëmijëve dhe ofrojnë mbështetje të përshtatshme për fëmijët viktime. Aktivitetet që zhvillon kjo qendër kryhen si rezultat i partneritetit ndërmjet Policisë së Shtetit, Prokurorisë, Spitalit Universitar dhe shërbimeve lokale të mbrojtjes së fëmijës, si dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijës e cila është përgjegjëse për funksionimin e kësaj qendre. Koncepti bazë i modelit Barnahaus është shmangia e riviktimizimit të fëmijës si rezultat i intervistave të shumëfishta nga profesionistë të ndryshëm.

*(Përshtatur nga raporti i parë i monitorimit i Komitetit të Lanzarotës, faqe 21.)

2.3 Të dhënat ekzistuese mbi situatën e abuzimit seksual ndaj fëmijëve në Shqipëri.

Në Shqipëri, ka shumë pak studime që trajtojnë çështje të dhunës dhe të abuzimit ndaj fëmijëve, veçanërisht çështje të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit. Përveç kësaj, të dhënat aktuale, megjithëse mjaft të pakta, tregojnë se abuzimi seksual i fëmijëve në rrethin e besimit është i fshehur dhe se raportimi nga institucionet zyrtare është mjaft i rrallë. Për më tepër, në Shqipëri nuk ka programe të specializuara me burime të qëndrueshme financiare, me staf të trajnuar, si pjesë e një mekanizmi efektiv dhe efikas të ndërhyrjes¹³.

Gjithsesi, bazuar në burimet zyrtare të informacionit, më poshtë ofrohet një përmbledhje sintetike e evidencës ekzistuese për vendin tonë:

- Sipas një studimi që përfshiu fëmijët e moshave 6-12 vjeç dhe 13-18 vjeç të realizuar në vitin 2003 nga Qendra e Trajtimit Multidisiplinor për Problemet e Keqtrajtimit të Fëmijëve, 11% e fëmijëve kishin patur ngacmime seksuale dhe 4% e tyre i kishin përjetuar ato në mjedisin familjar. Në tërësi, 4% e fëmijëve të përfshirë në këtë studim pranuan përjetimin e dhunës seksuale (Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2005)¹⁴.
- Studimi "*Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri*", i mbështetur nga UNICEF në vitin 2006, është ndër studimet e para që trajtoi gjerësisht çështjet e abuzimit të fëmijëve në Shqipëri. Lidhur me abuzimin seksual, në këtë studim, përveç rasteve të fenomenit të përdhunimit nga persona të panjohur, u konstatuan edhe raste të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit të fëmijëve¹⁵.
Subjektet e studiuara raportuan se 13.3% e tyre ngacmoheshin seksualisht. Sipas këtij studimi, shkolla është një mjedis ku mund të ndodhë abuzimi seksual. Po kështu, sipas këtij studimi, një në pesë ngacmues seksualë të fëmijëve (22.5%) është mësues. Tërheq vëmendjen fakti që ngacmimi seksual i raportuar nga fëmijët në sistemin e përkujdesjes shoqërore (prej 15%), ishte më i lartë se në mjedise të tjera. Në këtë studim, fëmijët e sistemit të përkujdesjes shoqërore raportuan autorësinë e ngacmimeve seksuale si vijon: 55.6% nga fëmijët e tjerë, 22.2% nga mësuesit dhe 22.3% nga persona të tjerë. Sipas studimit, rastet e abuzimeve seksuale, qoftë të atyre të realizuara, qoftë të atyre

të mbetura në tentativë, kryhen jo vetëm në shkollë, por edhe në shtëpi. Në studim u raportuan edhe raste të incestit nga babai, xhaxhai ose vëllai. Sipas fëmijëve, rreziqet nga përdhunimet vijnë nga njerëzit e shtëpisë, nga mësuesit meshkuj pas orës së zakonshme të mësimit, nga djemtë e lagjes, nga nxënësit më të rritur ndaj vajzave më të vogla, nga rojet e pallateve ose nga të panjohur. Një gjetje interesante e studimit ishte shqetësimi që shprehin fëmijët mbi nevojën e informimit më të plotë për këtë fenomen, si dhe për rolin që ka media në transmetimin e mesazheve parandaluese.

Problemet shëndetësore që shoqërojnë përdhunimin lidhen me probleme me frymëmarrjen, depresionin, shtatzënitë e padëshiruara dhe vetëvrasjet. Këto ishin vetëm disa fjalë-kyç që subjektet e studimit i përdorën për të ilustruar disa nga çrregullimet që pasonin dhunën seksuale ndaj të miturve. Sipas fëmijëve të përfshirë në këtë studim, nuk ekzistojnë ndërhyrje profesionale për përballimin e pasojave të një dhune të tillë. Sipas këndvështrimit të tyre, mungesat në këtë drejtim janë të dukshme në vendin tonë.

Lidhur me reagimin e familjeve ndaj vajzave të përdhunuara, në këtë studim u raportua se disa familje i largojnë vajzat nga shkollat e mëparshme dhe i dërgojnë në shkolla të tjera. Prindërit duket se vepronin kështu për t'i mbrojtur vajzat nga përdhunimet e tjera, si dhe për t'u mbrojtur nga stigmatizimi i opinionit.

- Studimi mbi “Prevalencën e Përvojave Negative gjatë Fëmijërisë” (*Community Survey on Prevalence of Adverse Childhood Experiences in Albania - ACE survey*) i realizuar në Shqipëri në vitin 2012, ofron të dhëna mbi abuzimin seksual gjatë fëmijërisë të rinjve shqiptarë¹⁶.

Kështu, nga 1437 studentë të pyetur mbi eksperiencat negative gjatë fëmijërisë (gjatë 18 viteve të para të jetës), 6% e tyre raportuan se ishin abuzuar seksualisht gjatë kësaj periudhe. Djemtë raportuan më shumë abuzim seksual në krahasim me vajzat gjatë periudhës së fëmijërisë së tyre (8.8% vs. 4.7%, përkatësisht).

Gjetjet e këtij studimi përforcojnë akoma më shumë lidhjen e fortë që ekziston midis eksperiencave të tilla negative, siç është abuzimi seksual dhe sjelljeve të rrezikshme shëndetësore. Kështu, subjektet që ishin abuzuar seksualisht, ishin më të predispozuar për të konsumuar duhan, alkool dhe drogë. Nga ana tjetër, viktimat e abuzimit seksual ishin 11 herë më të prirura drejt përpjekjeve për vetëvrasje dhe tre herë më të prirura për të patur një shtatëzani të padëshiruar.

- “Studimi Epidemiologjik Ballkanik mbi Abuzimin dhe Neglizhimin e Fëmijëve” (*Balkan Epidemiologic Study on Child Abuse and Neglect, BECAN*), i realizuar në Shqipëri në vitin 2013, kishte si qëllim identifikimin e numrit të raportuar dhe të zbuluar të rasteve të abuzimit dhe/ose neglizhimit ndaj fëmijëve në vendet e Gadishullit të Ballkanit. Ky studim hartëzoi shpërndarjen e fenomenit të keqtrajtimit të fëmijëve të grup-moshës 11-16 vjeç, pavarësisht nëse fëmijët ndiqnin ose jo shkollën. Ky studim u fokusua në identifikimin e prevalencës dhe incidencës së dhunës ndaj fëmijëve për sa i takon llojeve: dhunë psikologjike, dhunë fizike, ngacmim seksual, abuzim seksual, dhe neglizhim i fëmijëve¹⁷.

Nga një total prej 4351 fëmijësh të moshës 11 vjeç, 13 vjeç dhe 16 vjeç, u raportuan këto vlera të prevalencës dhe incidencës së ngacmimit seksual: prevalenca 11%, ndërsa incidenca 9%. Nga ana tjetër, 86% e fëmijëve të përfshirë në studim deklaruan se nuk kishin patur asnjëherë ngacmime seksuale.

Për sa i takon abuzimit seksual, prevalenca sipas këtij studimi rezultoi të ishte 4.9%, ndërsa incidenca 4.0%. Nga ana tjetër, 93% e fëmijëve raportuan të mos kishin qenë asnjëherë viktimat e abuzimit seksual.

- Nga një studim tjetër që pasoi studimin BECAN (të përmendur më lart), vajzat raportuan një nivel më të lartë të abuzimit seksual në krahasim me djemtë. Sipas këtij studimi (Hazizaj

dhe bp, 2013), nga 28 rastet e raportuara të dhunës seksuale, 75% e tyre përfshinin viktimë të gjinisë femërore. Grupimi i të gjitha formave të abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve nuk rezultoi në ndryshime sinjifikative sipas grup-moshës së fëmijëve. Në tërësi, ky studim zbuloi se të gjitha format e dhunës janë të pranishme tek fëmijët e vendit tonë, pavarësisht se magnituda e saktë është shumë e vështirë për t'u raportuar¹⁸.

- Ndërsa, sipas një studimi mbi profilin e fëmijëve shqiptarë të dhunuar, të realizuar nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) me Qendrën e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (IRCCRA), rezultoi se 3% e fëmijëve të dhunuar (dhe më pas të strehuar në Strehëzën e Tiranës) janë abuzuar seksualisht, përfshi këtu ngacmimet seksuale nga babai¹⁹.
- Studimi mbi abuzimin seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit sjell një panoramë të gjendjes së shërbimeve ekzistuese në mbrojtje të fëmijëve duke paraqitur pikat e forta dhe nevojën për përmirësim të mëtejshëm të këtyre shërbimeve, e parë kjo nga këndvështrimi i profesionistëve, prindërve dhe vetë fëmijëve të abuzuar. Gjithashtu, studimi na prezanton me normat sociale që kontribuojnë në shfaqjen e abuzimit seksual të fëmijës të tilla si kultura e dhunës, stigmatizimi i viktimës, vetëgjyqësia, rrethi i madh i besimit, diskriminimi gjinor, etj.

III. Gjetjet e Studimit.

3.1 Perceptime të Përgjithshme mbi Abuzimin Seksual të Fëmijëve në Rrethin e Besimit.

Në pjesën më të madhe të tyre, të gjithë pjesëmarrësit që morën pjesë në këtë studim pranuan se abuzimi seksual i fëmijëve në rrethin e besimit është një fenomen prezent. Shumica e profesionistëve u shprehën se abuzimi seksual i fëmijës ndodh kryesisht brenda rrethit të besimit.

“Fëmijët shqiptarë reagojnë ndaj të panjohurve, kështu që abuzimi kryesisht haset me njerëzit në rrethin e besimit, ku nuk jua merr mendja që mund të ndodhë kjo gjë”.

Nga analiza sasiore e rasteve ekzemplare që u shqyrtuan për këtë studim, rezulton se pothuajse të gjitha rastet ekzemplare (rreth 90%) konsistojnë në një profil social-ekonomik dhe psikologjik shumë të disfavourshëm të familjeve dhe të fëmijëve viktime të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit. Interesant ishte fakti që abuzimet seksuale brenda rrethit të besimit kishin ndodhur jo vetëm tek vajzat, por edhe tek djemtë. Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët që vijnë nga shtresa në nevojë u konsideruan si grupet më të brishta, tek të cilët mund të hasen me shpesh forma të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit.

Megjithatë denoncimi mbetet i ulët. Denoncohen kryesisht rastet me rrezik të lartë, të cilat raportohen fillimisht në polici. Profesionistët u shprehën se për shkak të paragjykitimit dhe stigmatizimit të viktimeve në shoqëri, si dhe të normave sociale që përforcojnë ruajtjen e sekretit familjar, shumë prindër refuzojnë të denoncojnë abuzimin. Rrjedhimisht, vetëm rastet më ekstreme, me rrezik të menjëhershëm (sipas përcaktimit të Protokollit të Mbrojtjes së Fëmijës) deklarohen dhe trajtohen nga sistemi.

Një arsye tjetër për mungesën e denoncimit lidhet edhe me mungesën e informacionit dhe ndërgjegjësimin në përgjithësi për çështjen e abuzimit seksual në rrethin e besimit. Profesionistët mendojnë se niveli i ulët i ndërgjegjësimin mbi ekzistencën e abuzimit në rrethin e besimit bën që, nga njëra anë fëmijët të mbeten të painformuar mbi kujdesin që duhet të kenë për veten, e nga ana tjetër, prindërit të jenë të pavëmendshëm ndaj shenjave dhe t'i lënë fëmijët në një rreth shumë të gjerë dhe të pa testuar besimi që bëhet predispozitë për abuzimin.

Duhet theksuar se kjo lidhet edhe me përkufizimin e rrethit të besimit. Në shumicën e rasteve, rrethi i besimit interpretohet si rrethi i ngushtë familjar ose farefisnor për fëmijët. Në fakt, nëse në rrethin e besimit do të konsiderohen të gjithë individët që shfrytëzojnë pozicionin e besimit që kanë me fëmijët, atëherë nevojitet edhe shqyrtimi i një rrethi më të zgjeruar.

Pjesa më e madhe e denoncimeve të fëmijëve të abuzuar seksualisht janë sipas profesionistëve të vërteta, ndërkohë që vetëm një pjesë e vogël e fëmijëve mund të kenë dhënë raportime false, si rezultat i manipulimeve prej prindërve apo kujdestarëve të tyre.

"Të rriturit ndoshta bëjnë kallëzime të rreme, por fëmijët mendojnë që jo"

Ndërsa prindërit (ata të fëmijëve të abuzuar seksualisht dhe të grupeve të disfavorizuar), konsiderojnë policinë si organin kryesor për të denoncuar rastin e abuzimit seksual të fëmijës, fëmijët konsiderojnë familjen ose shokët e ngushtë. Gjatë fokus grupeve, fëmijët shprehën se në përgjithësi kishin pak besim për të folur me mësuesit apo psikologun e shkollës. Gjithashtu, i ulët ishte besimi i këtyre fëmijëve për shërbimet shëndetësore publike dhe organet e drejtësisë. Sipas tyre ndëshkohen vetëm personat e varfër, pasi të pasurit i shpëtojnë drejtësisë.

3.2 Karakteristikat "Sasiore" të Rasteve të Abuzimit Seksual Ndaj Fëmijëve në Shqipëri

Të dhënat administrative të raportuara nga institucionet që morën pjesë në këtë studim, tregojnë se ka mungesë informacioni të saktë mbi rastet e abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit. Informacioni për rastet e trajtuara iu kërkua institucioneve publike, private dhe OJF-ve që ofrojnë shërbime për fëmijët.

Nga analiza e këtyre të dhënave rezulton se shumica e institucioneve kanë raportuar për të gjitha rastet e abuzimit tek fëmijët të identifikuar, referuar dhe menaxhuar prej tyre pa ofruar të dhëna specifike për rastet e abuzimit seksual (në shumicën e tyre) dhe aq më pak për abuzimin seksual në rrethin e besimit. Nga kjo pikëpamje, nuk është e mundur që të përftohet një shumatore numerike e rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve bazuar në të këto të dhëna.

Studimi tregoi se shumë institucione në nivel lokal përfshi Drejtoritë e Shëndetit Publik, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, apo Gjykatat e Shkallës së Parë nuk arrijnë që të identifikojnë raste të fëmijëve viktime të abuzimit seksual në rrethin e tyre të besimit.

Gjithashtu, nga të gjitha fokus grupet rezultoi se është i vështirë identifikimi i rasteve me abuzim seksual tek fëmijët; të dhënat nuk disagregohen deri në këtë nivel informacioni. Kjo situatë bën që shpesh të ketë mbivendosje të rasteve dhe vështirësi në identifikimin e abuzimeve seksuale brenda rrethit të besimit.

Rezultatet e plota "sasiore" të të dhënave administrative nga burimet zyrtare të informacionit për këtë studim paraqiten në mënyrë të detajuar në Shtojcën 2. Në mënyrë të përmbledhur, të dhënat kryesore administrative të përfutuara në këtë studim paraqiten më poshtë:

- Në total, 109 institucione në shkallë vendi raportuan lidhur me të dhënat administrative të kërkuara në kuadrin e këtij studimi. Nga ky numër total, 27 institucione nuk raportuan raste të abuzimit të fëmijëve (përfshi edhe abuzimin seksual), por informuan vetëm mbi aktivitetin e tyre të përgjithshëm dhe numrin përkatës të punonjësve.
- Nga 82 institucionet që raportuan mbi rastet e të gjitha llojeve të abuzimit të fëmijëve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Tiranë raportoi numrin më të madh të rasteve të abuzimit të fëmijëve për vitin 2014 dhe vitin 2015 (N=790). Më pas, Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve në Tiranë raportoi një numër prej 188 rastesh të abuzimit të fëmijëve. ARSIS raportoi një numër prej 72 rastesh të abuzimit të fëmijëve, kurse

Qendra Psiko-Sociale "Vatra" në Vlorë raportoi një numër prej 59 rastesh të tilla. Duhet theksuar se kërkesa ishte bërë për vitin 2014, por institucionet raportuan edhe rastet e vitit 2015.

- Për sa i takon rasteve të abuzimit seksual ndaj fëmijëve, numri më i madh i rasteve u raportua nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Tiranë, e cila për vitin 2014 dhe vitin 2015 regjistroi 46 raste të tilla. Më pas, Qendra Psiko-Sociale "Vatra" në Vlorë raportoi një numër prej 24 rastesh të abuzimit seksual ndaj fëmijëve. ARSIS raportoi 13 raste të tilla, ndërsa Drejtoria e Shëndetit Publik në Sarandë raportoi 10 raste të abuzimit seksual ndaj fëmijëve për të njëjtën periudhë kohore (2014-2015).
- Lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve në rrethin e tyre të besimit (përfshi këtu personat brenda familjes, komshinjtë, persona të njohur në rrethin familjar, mësues, etj.), Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Tiranë raportoi vetëm 4 raste të tilla (rreth 9% të totalit të fëmijëve të abuzuar seksualisht), ndërsa Qendra Psiko-Sociale "Vatra" në Vlorë raportoi 24 raste të tilla (100% të rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht). ARSIS raportoi 5 raste të tilla (38%), ndërsa Drejtoria e Shëndetit Publik në Sarandë raportoi 3 raste të tilla (30% e rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht). Duhet theksuar se nuk u ofrua informacion i detajuar për llojet e tjera të abuzimit seksual të fëmijëve, meqenëse edhe fokusi kryesor ishte tek rrethi i besimit.
- Për sa i takon gjinisë së fëmijëve viktime të abuzimit seksual në rrethin e tyre të besimit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Tiranë raportoi se 100% e rasteve (N= 4) ishin femra. Po kështu, edhe Qendra Psiko-Sociale "Vatra" në Vlorë raportoi se 100% e rasteve (N=24) ishin femra. Nga ana tjetër, Shërbimi Social i Korçës raportoi se 5 raste (80%) të abuzimit seksual të fëmijëve në rrethin e tyre të besimit ishin meshkuj. Në mënyrë të ngjashme, prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në Berat raportoi se rreth 75% e rasteve (N=10) të abuzimit seksual të fëmijëve në rrethin e tyre të besimit ishin meshkuj. Një verifikim i detajuar i atyre pak rasteve që u raportuan nga institucionet e tjera dëshmoi se rastet e fëmijëve të abuzuar seksualisht në rrethin e tyre të besimit i përkisnin të dyja gjinive.
- Lidhur me vërtetimin e akuzave ndaj dhunuesve të fëmijëve, vetëm Qendra Psiko-Sociale "Vatra" në Vlorë raportoi të kishte një shkallë prej 100% të vërtetimit të akuzave.
- Për sa i takon ndëshkimit të autorëve të abuzimit seksual ndaj fëmijëve, vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Tiranë raportoi se në 54% të rasteve (25 nga 46 raste të abuzimit seksual ndaj fëmijëve) ishin marrë masa ndëshkimore të rënda ndaj dhunuesve.

3.3 Normat Shoqërore mbi Abuzimin Seksual të Fëmijëve Brenda Rrethit të Besimit në Shqipëri

Bazuar në komentet e të gjithë pjesëmarrësve të përfshirë në studim mund të evidentohen disa norma sociale që kontribuojnë në shfaqjen e abuzimit seksual të fëmijës:

Kultura e dhunës dhe e tolerancës ndaj dhunës. Ekzistenca e dhunës si normë shoqërore pengon individët për të identifikuar, për t'u ndërgjegjësuar, për të referuar, apo për të ofruar mbështetje dhe shërbime në rastet e dhunës në përgjithësi. Duke qenë gjerësisht e përhapur, dhuna rrit pragon e ndjeshmërisë individuale ndaj fenomenit. Rrjedhimisht, reagimi shfaqet vetëm kur kemi të bëjmë me raste të rënda ose emergjente të abuzimit. Në këtë drejtim një profesionist u shpreh:

“Drejtori apo mësuesi nuk i raporton rastet e fëmijëve të dhunuar nga prindi pasi ai e dhunon edhe vetë nxënësin.”

“Unë e dhunova sepse më dhunoi fëmijën dhe i ati më dhunoi mua dhe përfaqësuesi i shtetit më pa dhe nuk ndërhyri”.

Është ky zinxhiri i dhunës së përshkruar nga një prind në këtë studim, i cili vijon si më poshtë:

“Tek kryeplaku i fshatit nuk kam fare besim sepse në një situatë të caktuar ai ishte i pranishëm kur dikush më goditi me shkelm pasi unë godita fëmijën e tij sepse ky i fundit kishte goditur fëmijën tim, por djali i tij ishte më i madh se djali im dhe unë i dola në mbrojtje djalit tim. Ai burri më goditi me shkelma përpara syve të kryeplakut dhe kryeplaku nuk ndërhyri fare për të më mbrojtur. Të varfërit nuk i do dhe nuk i mbron njeri.”

Pothuaj në të gjitha fokus grupet me profesionistë dhe përfaqësues të medias përmendet frika dhe pasiguria, qoftë kjo e mjekëve, mësuesve, punonjësve të NJMF-së, të cilët ndihen të kërcënuar nga abuzuesit dhe familjarët e tyre, frika e gazetarëve nga eprorët e tyre që çon në shtrembërimin e lajmit, apo frika e specialistëve të sistemit të mbrojtjes së fëmijës nga përballja me mediat. Kërcënimet nga abuzuesit, familjarët, apo drejtuesit janë përmendur gjerësisht në këtë studim, duke pasqyruar në këtë mënyrë një kulturë të vërtetë dhune.

Lidhur me pasqyrimin e papërshtatshëm në media të rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht, një gazetar komentoi:

“Mentaliteti i dhunuar i gazetarëve dhe shëndeti mendor jo i mirë i tyre na kanë çuar në këtë gjendje.”

Gjithashtu, përfaqësuesit e medias përmendën interesimin e publikut për lajme sensacionale dhe nevojën për të shtrembëruar dhe ekzagjeruar me raportimin e rasteve në mënyrë që publiku të shfaqë interes.

Sipas profesionistëve ka një binom të dyanshëm ndërmjet mediave dhe publikut sa i përket prirjes për të publikuar lajme me natyrë sensacionale dhe provokuese që lidhen me abuzimin seksual të fëmijëve. Ata argumentojnë se ka një tërheqje të përgjithshme nga publiku për të tilla informacione, të cilat përforcojnë edhe raportimin e medias në këtë drejtim.

Stigmatizimi dhe diskriminimi i viktimës. Pjesëmarrësit në studim përmendën shpesh se prindërit refuzojnë të denoncojnë rastet sepse ato bëhen publike dhe viktimat e abuzimit seksual stigmatizohet nga shoqëria. Për shumë prindër denoncimi i abuzimit seksual do t'i sillte fëmijës më shumë dëm sesa dobi. Fëmija do të stigmatizohej, ndërkohë që abuzuesi nuk do të merrte ndëshkimin që i takon. Rrjedhimisht, shumë prindër bëjnë të paditurin, nuk denoncojnë, apo lehtësojnë pozitat e abuzuesit me dëshmitë e tyre.

Diskriminimi gjinor, "nderi" dhe martesë. Çështje të tjera evidentohen kur viktimat e abuzimit seksual janë femra. Një prej tyre lidhet me besimin se një vajzë e abuzuar seksualisht nuk mund të martohet në të ardhmen. Disa prindër p.sh. pohuan:

"Nderi për ne është thelbësor dhe nëse përhapet lajmi atëherë kjo është shumë e rëndë pasi vajza mund të mbetet pa martuar."

Për më tepër, në shumë raste familjarët jo vetëm nuk kanë denoncuar rastet e abuzimit, por kanë inkurajuar dhe aprovuar martesat e vajzave me abuzuesit. Në rastin e vajzave adoleshente, ekziston mendësia se *"mund ta kërkojnë vetë"*, prandaj ka edhe prirje për t'i bërë fajtoreshë për çfarë ka ndodhur. Ndërsa raportimi i rasteve të abuzimit seksual tek djemtë bëhet akoma më i vështirë, pasi ai është i papranueshëm dhe i pabesueshëm për shkak të perceptimit të rolit të djalit në shoqëri.

Ruajtja e sekretit familjar. Është kjo një normë tjetër e shoqërisë shqiptare që bëhet pengesë për denoncimin e abuzimeve që ndodhin brenda familjes. Ekziston ende mentaliteti se *"çfarë ndodh brenda familjes, mbetet brenda familjes"*, që vlerëson si të shenjta privatësinë e familjes, ushqen sekretin dhe heshtjen, stigmatizon fëmijët viktimë të abuzimit seksual dhe bën që profesionistët, prindërit dhe fëmijët të hezitojnë ta raportojnë atë. Duke ruajtur sekretin viktimat izoloohen dhe nuk kanë asnjë mbështetje sociale për të përballuar situatën. E pyetur për mundësinë që fëmijët të tregonin në shkollë rreth abuzimit që u ndodhte në shtëpi, nëna u përgjigj:

"Jo jo, se e kam pak fajin dhe unë për këtë. Ne i mbanim në familje. As njerëzve të afërt nuk ua tregojmë."

Idealizimi i familjes. Idealizimi i familjes si vendi që ofron siguri maksimale për fëmijët promovon idenë se figurat familjare janë të paprekshme. Argumenti i paraqitur këtu lidhet më tepër me mënyrën e përkujdesit të fëmijëve që shpesh bazohet në rrjetin mbështetës të familjes, familja e zgjeruar, apo komuniteti.

Vetëgjyqësia. Një pjesë e pjesëmarrësve në fokus grupe përmendën mungesën e besimit në organet e drejtësisë dhe vetëgjyqësinë si një faktor tjetër që influencën abuzimin seksual të fëmijëve. Hakmarrjet personale të familjarëve pengojnë shumë fëmijë që të denoncojnë abuzimin duke dashur të shmangin konfliktet dhe mbrojnë familjarët.

Besimi se sistemi nuk mbron të varfërit. Shpesh u përmend ky besim apo ky konstatim nga profesionistët, prindërit, fëmijët dhe gazetarët e përfshirë në studim. Konkretisht, një prind përmendi:

"Nëse je i varfër, të gjithë sistemin e ke kundër. Kur je i varfër, çështja mbyllet nga pala tjetër pasi paguhen prokurorët e gjyqtarët. Është diçka shumë e trishtueshme për ta pranuar, por të varfërit janë shpesh viktimë të abuzimit dhe ata nuk mbrohen aspak nga sistemi."

Dihet se varfëria është në vetvete një faktor i lartë rreziku për abuzimin seksual të fëmijëve. Por besimi se njerëzit e varfër janë të pambrojtur nga sistemet shtetërore rrit edhe më shumë rrezikun e fëmijëve të varfër për abuzim.

3.4 Parandalimi dhe Mbrojtja e Fëmijëve nga Abuzimi Seksual në Rrethin e Besimit

Në përgjithësi, prindërit e fëmijëve të abuzuar apo ata nga grupet e disfavorizuara u shprehën se pak bëhet për parandalimin e abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit. Ka mungesë të mbështetjes së fëmijëve nga psikologu apo mësuesit në shkollë.

Përgjithësisht, edhe pse ndihma emergjente në rastet e abuzimit seksual të fëmijëve është e kënaqshme, ndihma afatgjatë për rehabilitimin e fëmijëve viktime të abuzimit seksual është e paplotësuar.

Masat Parandaluese. Shumë profesionistë u shprehën se ka nevojë për më shumë ndërgjegjësim të fëmijëve, prindërve, dhe komunitetit rreth abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit. Ndërhyrjet multidisiplinare për rritjen e këtij ndërgjegjësimi janë të pakta dhe kanë nevojë të përforcohen.

Pavarësisht se në kulturën shqiptare lidhjet dhe rrjetet sociale janë të gjera dhe fëmija dhe familja mund të gjejnë mbështetje, në raste të tjera ky rreth i gjerë besimi sipas profesionistëve mund të kthehet në risk. Një profesionist pohoi:

“Pikë e dobët është rrethi i madh i besimit sepse ky lë shkak për abuzime, pra ka nevojë për sensibilizimin e shoqërisë. Familja duhet të ndikojë në ndërgjegjësimin rreth këtyre çështjeve; në shkollë ka kurrikula për temat e edukimit seksual, por duhen shtuar orët dhe duhen thjeshtuar mesazhet. Duhet të ofrohen module që adresojnë këto tema sepse ndikojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të fëmijëve për këto probleme”.

Identifikimi i hershëm. Prindërit e fëmijëve të abuzuar seksualisht gjatë intervistës përmendën se ishte e vështirë për fëmijët të kërkonin ndihmë në shkollë apo komunitet kur abuzimi ishte duke ndodhur. Psikologu i shkollës nuk ishte lehtësisht i aksesueshëm për fëmijët. Një nënë e intervistuar përmendi:

“Ne e mbanim në familje. As njerëzve të afërt nuk ua tregonim. I thosha vajzave: -a keni psikolog në shkollë? Thoshte, - janë, por kot që janë. Zyra është e mbyllur. As s’na mbledhin, asgjë.”

Ndërsa lidhur me mësuesit ajo u shpreh se ata nuk ishin të afërt me fëmijët. Përkundrazi, mësuesit ishin më vete burim dhune verbale dhe psikologjike.

Ndërkohë, prindi i një fëmije tjetër të abuzuar, u shpreh gjatë intervistës se fëmija kishte ndryshuar sjelljen pasi kishte filluar abuzimi, por në shkollë askush nuk e kishte evidentuar këtë ndryshim, apo nuk ishte interesuar për të:

“Mësuesit e vinin re që djali sillej ndryshe kohët e fundit para ngjarjes dhe ishte me disa probleme. Por, gjithsesi, nuk është se bënë ndonjë gjë për ta parandaluar ngjarjen.”

Identifikimi i hershëm i rastit është akoma më i vështirë në komunitete të marginalizuara, siç është edhe komuniteti Rom. Probleme që lidhen me varfërinë e skajshme, largimin e fëmijëve nga shkolla, mungesën e regjistrimeve të fëmijëve, adoptimet informale, etj., i rrezikojnë më shumë fëmijët e këtij komuniteti dhe vështirësojnë identifikimin dhe ndërhyrjen.

Diskriminimi është gjithashtu një nga çështjet madhore që vështirëson identifikimin e abuzimit seksual të fëmijëve në këtë komunitet. Prindërit në komunitetin Rom u shprehën:

“Dobësia kryesore është se fjalët dhe denoncimet e komunitetit Rom nuk merren seriozisht nga organet përkatëse dhe shpesh bien në vesh të shurdhër!”

Sipas profesionistëve, referimi pranë NJMF-së është i rrallë pasi organi parësor ku zakonisht raportohen këto lloj rastesh është policia. Kjo, **sipas profesionistëve**, ndodh për disa arsye: (i) shumë njerëz nuk janë në dijeni të ekzistencës së kësaj njësie; (ii) sepse sistemi shëndetësor dhe ai arsimor nuk është bashkëpunues për shkak të frikës, neglizhencës, apo mungesës së njohurive specifike; dhe (iii) për shkak të mungesës së besimit se NJMF ka kompetencat, strukturat dhe aftësitë për të ofruar mbrojtje dhe shërbim profesional.

“Nuk ka arritur të krijohet besimi tek NJMF, sepse policia është më e madhe si institucion.”

Raportimi nga Profesionistët. Një pjesë e madhe e profesionistëve që kishin qenë në kontakt me fëmijët e abuzuar seksualisht brenda rrethit të tyre të besimit u shprehën se nuk ndihen të sigurt dhe se marrin shpesh kërcënime nga abuzuesit apo familjarët e tyre, çka i bën ata të heqin dorë nga raportimi i rasteve.

Një profesioniste shprehet:

“Kushëriri 16-vjeçar abuzonte me një vajzë 6-vjeçare prej tre vjetësh, d.m.th. që kur ajo ishte 3 vjeçe. Ata u shpërngulën jashtë Shqipërisë. Mjeku atëherë nuk e kishte bërë denoncimin se e kërcënonin familjarët.”

Edhe gazetarët përmendën se mjekët dhe mësuesit kanë frikë dhe nuk duan të implikohen me raste të tilla. Rrjedhimisht ata nuk i denoncojnë rastet kur dyshojnë për abuzim seksual.

Megjithatë profesionistët shprehen se ka rrjedhje të informacionit (humbja e konfidencialitetit), dhe për pasojë ndodh edhe raportimi i papërshtatshëm në media. Mungesa e sigurisë dhe frika

e profesionistëve nga kërcënimi, si edhe stigmatizimi i viktimës shfaqen si arsyet kryesore të mos-denoncimit të rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht brenda rrethit të tyre të besimit.

“Mënyra e deritanishme e mbulimit të abuzimit seksual nga media frikëson viktimat dhe ata që duan të denoncojnë.”

Një tjetër problem që haset nga profesionistët është kushti i bërjes së kallëzimit penal në polici në mënyrë që policia të nisi hetimet, në rastet kur një person ose profesionist ka dyshime se fëmija mund të jetë i/e abuzuar seksualisht. Duket se ekziston ngurrim mes profesionistëve lidhur me nevojën për denoncim dhe investigimin e rasteve nga policia. Një profesionist pohoi:

“Kur kam dyshim për një X nxënës të shkollës se mund të abuzohet, shkoj te rajoni i policisë sepse dua ta vërtetoj, dua të nis një investigim... Por ata më thonë se duhet një denoncim. Unë dua që të bëhet vetëm investigim sepse nuk jam e sigurt, kam dyshime. Policia duhet të niset mbi një denoncim real, dmth sikur të jesh e sigurt, por unë dua vetëm investigimin.”

Ndihma emergjente. Problemi më i madh i evidentuar ishte mungesa e qendrave të emergjencës, apo shërbimeve të tjera ku fëmija të mund të referohet. Një pyetje shqetësuese për profesionistët është:

“Ku do shkojë fëmija viktimë e abuzimit seksual në rrethin e besimit nëse nuk shkon dot në shtëpi pas ngjarjes?”

Profesionistët u shprehën se shërbimet shëndetësore nuk kanë mjedise të veçanta për të trajtuar fëmijët e abuzuar seksualisht (p.sh. në maternitet, nëse fëmija duhet të kryejë ekzaminimin gjinekologjik). Për më tepër evidentohet mungesa e fondeve për të paguar psikologun, apo për shërbime të tjera që nevojiten në menaxhimin e situatës emergjente në rastin e një fëmije të abuzuar seksualisht. Shpesh profesionistët u shprehën për mungesën e mjeteve të transportit që i pengon ata të mbulojnë si duhet zonën.

Një këndvështrim tjetër lidhur me shërbimet e marra menjëherë pas denoncimit, vjen nga prindërit, fëmijët e të cilëve ishin abuzuar seksualisht dhe nga vetë fëmijët e abuzuar. Kështu, prindërit u shprehën se kanë ndjerë interesim dhe mbështetje si nga organet shtetërore, ashtu edhe nga organizata joqeveritare, pasi kanë bërë denoncimin. Ata përmendën se janë trajtuar mirë në polici, nga psikologu, mjeku dhe shërbimet sociale. Në disa nga komentet e tyre, ata konstatuan:

“Më kanë mbështetur shumë policia, shërbimet sociale, shëndetësia. Kanë bërë të pamundurën për mua dhe djalin tim.”

Një prind tjetër u shpreh:

“Krahasuar me jashtë shtetit nuk e prisja këtë gatishmëri institucionale. Në komisariat kam pasur mbështetje shumë të madhe. Vetëm një herë kam shkuar dhe na thanë që do keni ndihmën tonë sa herë që doni.”

Në mënyrë të ngjashme, njëri nga fëmijët e abuzuar përshkroi se ishte trajtuar mirë në polici pasi kishte bërë deklaratën.

“Kur shkuam në polici u lehtësova shumë sepse ata më thanë, - mos ki frikë se do të të mbrojmë ne.”

Ai tregoi gjithashtu se mjeku dhe psikologu e kishin trajtuar mirë dhe kishte marrë ndihmën e nevojshme.

Gjithsesi, edhe në mes prindërve, fëmijët e të cilëve ishin abuzuar seksualisht, ka qëndrime dhe eksperiencë të ndryshme. Kështu, nëna e një fëmije Rom të abuzuar seksualisht, e cila e kishte adoptuar në mënyrë informale fëmijën, u shpreh se fëmija iu mor dhe u strehua në Shtëpinë e Fëmijës, ndërkohë që ajo nuk u konsiderua apo informua lidhur me trajtimin dhe shërbimet që iu ofruan atij.

Një nga prindërit e intervistuar u shpreh se ata i janë drejtuar medias për të marrë më shumë ndihmë nga sistemi. Duke qenë një familje e varfër, e neglizhuar dhe nëpërkëmbur, ata e konsideruan median si aleatin që do t'i ndihmonte të bëheshin të dukshëm për strukturat shtetërore në mënyrë që të merrnin mbrojtjen dhe ndihmën e nevojshme. Nëna e fëmijës u shpreh:

“Unë jam e kënaqur me mbështetjen që kam marrë. Ndoshta kjo ka ardhur sepse rasti i djalit tim u bë shumë mediatik dhe ndoshta tërhoqi vëmendjen e gjithë strukturave. Nuk mund të them për rastet e tjera.”

Ndonëse shërbimet emergjente (shërbimet që merr fëmija në momentin e parë) kanë mangësi, në tërësinë e tyre ato janë më efektive që i ofrohen fëmijës. Grupi multidisiplinor mbledhet, profesionistët interesohen dhe fëmija merr ndihmën e parë. Për shumë profesionistë problem i konsiderueshëm mbetet ndjekja e rastit në vazhdimësi. Një prej tyre është shprehur:

“Pas denoncimit të parë në polici dhe kalimit të periudhës emergjente, është e paqartë se ku duhet të referohet fëmija. Ligji në letër mund të lexohet, por zbatimi i tij është i vështirë, strukturat nuk përgjigjen, për arsye financiare apo vakumi ligjor mendoj.”

Ndihma afatgjatë dhe rehabilitimi. Pas kapërcimit të fazës emergjente fëmijët e abuzuar seksualisht, por edhe familjarët e tyre mbeten në situatë të vështirë dhe me shumë nevoja të paplotësuar. Nevojat ekonomike, për mbështetje psikologjike dhe siguri plotësohen minimalisht nga sistemi i mbrojtjes së fëmijës. Profesionistët konstatojnë mungesën e shërbimeve mbështetëse dhe atyre të specializuara për fëmijët e abuzuar seksualisht dhe familjarët e tyre:

“Shërbimet sociale për fëmijët e abuzuar seksualisht janë aktualisht vetëm shërbime të emergjencës, pra ndihma akute jepet goxha mirë. Problem është ndjekja e rastit në vijimësi.”

Prindërit e intervistuar theksuan gjerësisht nevojën për shërbime psikologjike. Ata pohuan se fëmijët janë ndjerë mirë pas takimeve të para me psikologun, por këto takime nuk kanë vijuar:

“Në fakt vajzat kanë bërë një takim me psikologun dhe ishin më mirë pastaj kur erdhën në shtëpi, por kaq ishte... Duhet të kenë takime më të shpeshta se nga takimi i parë dolën shumë mirë.”

Një nënë tjetër u shpreh:

“Shërbimi i psikologut dhe punonjësesh sociale është shumë i rëndësishëm për momentin. Djali ende nuk e ka kaluar traumën dhe i ka të nevojshme këto shërbime. Megjithatë, psikologu i shkollës vjen rrallë, por është përpjekur me të vetën për të ndihmuar djalin tim.”

Prindërit e fëmijëve të abuzuar shprehën mungesën e shërbimeve mbështetëse për vetë ata si dhe theksuan nevojën e ofrimit të këtyre shërbimeve edhe për anëtarët e tjerë të familjes.

“Unë vetë doja psikolog, por s’kam pasur. Më kujtoheshin skena të arrestimit. Kam nevojë për psikolog dhe unë, por ata janë të shtrenjtë.”

Një tjetër aspekt i ndihmës dhe shërbimeve mbështetëse lidhet edhe me pasojat ekonomike që mund të sjellë abuzimi seksual i fëmijës në rrethin e besimit, në rastet kur abuzuesi është një njëri nga prindërit. Në rastet kur është p.sh. kryefamiljari abuzues, arrestimi i tij bën që familjes t’i ikë njëkohësisht edhe burimi kryesor i të ardhurave. Një nënë u shpreh në lidhje me ndihmën ekonomike:

“Institucionet që japin ndihma ndaj familjeve janë shumë pak ndihmuese. Çfarë do bësh me 30 000 (të vjetra) që japin për fëmijën? S’e di. Unë kam 4 fëmijë. Edhe nga ana shëndetësore, vjen dimri dhe fëmijët sëmuren. Gripin e marrin që të katërt. Vetëm për një grip unë harxhoj 40 000 – 60 000 lekë për ilaçet.”

Gjithashtu një prind pohoi se kishte komunikuar me NJMF për t’i siguruar librat e fëmijëve. Një tjetër prind përmendi ndihmën e organizatave jo fitimprurëse.

Për më tepër, prindërit e fëmijëve të abuzuar dhe vetë fëmijët e abuzuar shprehën se u duhet të përballen dhe me diskriminimin, përbuzjen dhe talljen e fëmijëve të tjerë dhe gjithë komunitet. Nuk pohohet për ndonjë ndërhyrje nga mësuesit, psikologu i shkollës, apo përfaqësuesit e sistemit të mbrojtjes së fëmijës për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit dhe për të mundësuar rehabilitimin e fëmijës, gjë për të cilën ai ka shumë nevojë siç u shpreh edhe vetë njëri prej tyre:

“Unë kam nevojë për mbështetje në shkollë dhe shoqëri. Nuk e di si mund të arrihet kjo. Tani për tani vetëm tallen me mua dhe e kam shumë të vështirë. Dua të largohem nga ky vend.”

Në një pjesë rastesh familja është shpërngulur për t’i shpëtuar diskriminimeve të komunitetit ku jetonin.

Trajtimi i fëmijës në procesin e mbrojtjes dhe masat e dënimit për autorët. Një aspekt tjetër që ka nevojë të trajtohet dhe përmirësohet është ai i kodit të sjelljes së profesionistëve që trajtojnë fëmijët e abuzuar seksualisht. Profesionistët, por edhe fëmijët pjesëmarrës në këtë studim, kanë përmendur raste ku ata janë trajtuar pa respekt nga mjeku që i ka vizituar. Njëri prej tyre u shpreh:

“Nuk jam i kënaqur. Edhe kur vizitohem tek mjeku nuk më trajtojnë mirë. Mjeku i familjes është i paedukatë me mua... Nuk kam besim tek mësuesit. Të gjithë në shkollë tallen me mua dhe mësuesit nuk bëjnë asgjë... në shkollë psikologu vjen rrallë.”

Një profesionist shprehet se: *“Mjekët ligjorë apo të specialiteteve të tjera sillen shumë keq me fëmijët viktime të abuzimit. Janë brutalë dhe të patrajnuar.”* Gjithashtu, raste komunikimi të papërshtatshëm janë raportuar edhe për profesionistë të tjerë të sistemit të mbrojtjes së fëmijës. Gjithashtu gazetarët raportuan për raste ku mjeku apo psikologu kishte diskriminuar fëmijën, kryesisht kur bëhej fjalë për fëmijë të komunitetit Rom.

Një problem tjetër që lidhet me denoncimin e rastit ka të bëjë me marrjen disa herë në pyetje të fëmijëve të abuzuar, 3-4 herë, gjë e cila është e dhimbshme për fëmijën.

“Duhet që kur bëhet vlerësimi i fëmijës, ky vlerësim të bëhet nga punonjësja sociale dhe psikologu bashkë për të evituar që fëmija të kthehet në ‘tabelë qitjeje’ duke u pyetur disa herë, edhe nga persona të pakualifikuar për këtë punë. Nuk ka shërbime sociale të specializuara për ASF”.

Problematike është edhe mungesa e psikologut në komisarate. Në organikën e komisarateve pozicioni psikolog ndodh që t’i caktohet një juristi. Rrjedhimisht, ka ndodhur që fëmija të pyetet në komisarati pa praninë e psikologut. Në këtë rast fëmija jo vetëm që nuk merr mbështetjen psikologjike që i takon gjatë dhënies së dëshmisë, por për më tepër, bën që dëshmia e fëmijës të konsiderohet e pavlefshme. Një rast i tillë u dëshmua nga njëri prej profesionistëve, i cili u shpreh:

“Ishte një rast që duhet ta merrte një psikolog për intervistë dhe e mori juristi, por ai s’ ishte i përgatitur. Pastaj avokati i palës tjetër e hodhi poshtë dëshminë sepse pretendoi se personi që ia kishte marrë nuk ishte psikolog në profesion, dhe nuk u quajt dëshmia e fëmijës.”

Mungesa e sigurisë është një çështje tjetër e rëndësishme e përmendur nga prindërit e fëmijëve të dhunuar. Kërcënimet kanë qenë intensive gjatë periudhës së denoncimit dhe gjyqit. Prindërit përmendën:

“Kisha presion të jashtëzakonshëm për të tërhequr akuzën. Na goditnin me gurë kur shkonim në seancat gjyqësore.”;

“Më bënë presione e më thonin: - u bë ç'u bë, ti duhet ta falësh!”;

“Pala e akuzuar arriti deri aty sa të kërcënonte djalin tim me vdekje.”

Dy nga tre prindërit e fëmijëve të abuzuar pjesëmarrës në këtë studim, pohuan se abuzuesit nuk u ndëshkuan siç meritonin, duke qenë sërish burim rreziku për familjen e tyre, si edhe për individë të tjerë. Ky fakt ka hequr besimin e tyre tek sistemi i drejtësisë dhe i ka bërë të ndihen më të pasigurt. Një prej prindërve u shpreh:

“Që kur autori doli nga burgu, nuk kam aspak besim tek sistemi i drejtësisë tek ne. Sikur të funksiononte drejtësia siç duhet do isha shumë më e qetë shpirtërisht, unë dhe djali im.”

Në mënyrë të ngjashme, edhe marrëdhënia me organet e drejtësisë ka qenë zhgënjyese për fëmijët. Njëri nga fëmijët e abuzuar u shpreh se u ndje i sigurt dhe i mbrojtur pasi bëri denoncimin, por ai u zhgënjye nga dënimi i ulët që gjykata i kishte dhënë abuzuesve dhe u shpreh se ndihej sërish i pasigurt.

Çështje Strukturore të Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri

Mangësi lidhur me numrin e burimeve njerëzore. Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës, duke qenë se nuk mbulojnë gjithë territorin e vendit dhe përbëhen vetëm nga një specialist janë shumë të limituara për të përballuar nevojat e zonave që ato mbulojnë. Kjo gjë limiton edhe mundësinë e ofrimit të shërbimit në 24 orë. Specialistët u shprehën se çështja komplikohet më tej për shkak të ndryshimeve territoriale. Edhe sipas gazetarëve sistemi nuk është efektiv në ofrimin e shërbimeve që i nevojiten fëmijës dhe nuk përgjigjet jashtë orarit zyrtar.

Lidhur me vlerësimin e rasteve, një pjesë e profesionistëve u shprehën se numri i kufizuar i specialistëve e bën të pamundur vlerësimin në thellësi të tyre.

“Ka vetëm 1 punonjës në NJMF, dmth ka pak staf”.

Për më tepër, efektiviteti i sistemit pengohet edhe nga mungesa e psikologëve apo vështirësia e gjetjes së tyre në orët e pasdites apo natës. Mungesa e psikologëve në shkolla ose prania e pamjaftueshme e tyre (p.sh. 1 herë në javë), apo mungesa e stafit shëndetësor në shkolla shkakton gjithashtu pengesa.

Gjithashtu, monitorim-vlerësimi i efikasitetit të menaxhimit të rasteve është një detyrë tjetër që askush nuk ka kohë dhe mundësi ta realizojë.

"Fëmija duhet të monitorohet, këtu nuk trajtohen mirë këto raste... sidomos ato që janë në rrethin e besimit.

Mungesa e njohurive dhe aftësive profesionale. Të gjithë profesionistët e pyetur shprehën nevojën e trajnimit dhe rritjes së kapaciteteve të tyre për të trajtuar specifikisht rastet e abuzimit seksual të fëmijëve. Përveç punonjësve të NJMF, për trajnime të vazhduara në këtë drejtim kanë nevojë edhe mjekët, psikologët, dhe oficerët e policisë të përfshirë në sistem. Mësuesit janë gjithashtu një kategori e identifikuar prej tyre. Një problem tjetër i përmendur ka të bëjë me ndërrimet e shpeshta të stafit, dhe largimin e punonjësve të kualifikuar. Profesionistët u shprehën se duhet gjetur një mekanizëm për të mbrojtur ekspertët nga largimi i punës.

"Nëse identifikohet një ekspert, ai duhet të bëhet "imun" nga sistemi që, p.sh, për 5 vjet të mos lëvizë nga pozicioni i tij i punës dhe të trajnohet në vijimësi për të vlerësuar fëmijë të tillë."

Pamjaftueshmëria e njohjes së kuadrit ligjor. Profesionistët shprehen kryesisht se ana ligjore për abuzimin seksual të fëmijëve është e plotë, edhe pse ata shpesh reflektojnë mosnjohje të udhëzimeve për zbatimin e tyre. Kështu, ata i konsiderojnë si mangësi ligjore vështirësitë për të vepruar në rastet me rrezik të menjëhershëm, kur fëmija duhet larguar kundër vullnetit të prindërve, edhe pse Protokollin e Mbrojtjes së Fëmijës përshkruan mënyrën se si duhet të veprohet në situata të tilla. Një pjesë e profesionistëve u shprehën se ata kanë pak kompetenca për të vepruar kur prindërit nuk janë bashkëpunues. Një profesionist për shembull sqaroi:

"Në të gjithë procesin punonjësi social është në dorën e familjes. Nuk ka hapësira për të vepruar. Edhe për largimin e fëmijës nga shtëpia duhet aprovimi i prindit me deklaratë noteriale. Nëse prindi refuzon, s'ke çfarë bën... Madje edhe në rastet kur njëri nga prindërit është në burg, përsëri, duhet deklarata. Kemi pasur një rast dhe kemi shkuar deri në burg dhe e kemi gjetur atë babain për t'i marrë deklaratën."

Çështje të bashkëpunimit ndërinstucional dhe referimit. Megjithëse Protokollin e Mbrojtjes së Fëmijës përcakton shumë qartë detyrimin që ka çdo institucion (përfshi këtu institucionet shëndetësore dhe arsimore) për të referuar rastin si dhe për të bashkëpunuar me NJMF dhe gjithë Grupin Multidisiplinar, pjesëmarrësit në studim u shprehën për mungesë referimesh apo bashkëpunimi me institucionet shëndetësore dhe ato arsimore, ngurrim të tyre për të denoncuar rastet apo për t'u përfshirë në trajtimin dhe rehabilitimin e tyre. Gjithashtu bashkëpunimi i NJMF me policinë ka probleme. Nga njëra anë punonjësit e NJMF pohojnë se nuk informohen mjaftueshëm nga policia pasi inspektorët e policisë ndërrohen shpesh apo nuk janë në dijeni të ekzistencës së NJMF, dhe nga ana tjetër punonjësit e policisë shprehin vështirësitë e tyre për të kontaktuar me specialistët e NJMF sidomos pas orarit zyrtar.

Paqartësia, mbivendosja e roleve dhe mungesa e përshkrimeve të punës. Edhe pse Protokollin e Mbrojtjes së Fëmijës përshkruan qartë detyrat dhe përgjegjësitë e profesionistëve të ndryshëm që përfshihen në sistemin e mbrojtjes së fëmijës, një pjesë e profesionistëve u shprehën për mungesë të një përshkrimi të detajuar të punës që shkakton paqartësi, shpeshherë mbingarkesë dhe mbivendosje mes profesionistëve. Gjithashtu u prezantua edhe ekzistenca e rasteve ku një

person mbulon dy pozicione si p.sh. atë të specialistit në NJMF dhe të administratorit social. Një profesioniste u shpreh:

“Administratorët shoqërorë bëjnë vetëm vlerësim të përciptë, por nuk i hyjnë në thellësi problemeve të familjeve apo viktimave të ASF, sepse janë të pakët në numër dhe nuk mund t’i mbulojnë të gjitha”.

Mungesa e fondeve dhe e infrastrukturës së nevojshme. Punonjësit e NJMF u shprehën se nuk kanë zyra apo ambiente të veçanta për të pritur dhe dëgjuar fëmijët e dhunuar, duke mos respektuar dot as fizikisht konfidencialitetin e tyre. Ambiente të përshtatshme për dëgjimin e këtyre fëmijëve nuk ekzistojnë as në komisariate, apo nuk përdoren në rastet kur janë. Edhe pse ka disa standarde të përshkruara në Protokollin e Mbrojtjes së fëmijës së abuzuar, mbi funksionimin e NJMF-ve, përsëri ato në realitet nuk realizohen.

Besimet dhe qëndrimet e profesionistëve ndaj sistemit të mbrojtjes¹ së fëmijës së abuzuar seksualisht. Ndonëse profesionistët vlerësuan ngritjen e këtij sistemi dhe përkushtimin e shumë profesionistëve të përfshirë, ata shprehën gjithashtu mjaft rezerva për efikasitetin e sistemit. Shumë prej tyre shprehën se në gjendjen aktuale, ky sistem jo vetëm që nuk ofron një përkujdesje cilësore për fëmijën, por mbart gjithashtu rrezikun e dëmtimit të fëmijës. Disa nga komentet në këtë drejtim ishin: *“Të paktën në mos e bëjnë më keq, të mos e dëmtojnë më shumë.”*, ose: *“shërbimi jo i specializuar e përforcon traumën”*; apo *“Mund të themi që fëmijët viktimë të abuzimit seksual janë në pjesën më të madhe të rasteve të pambrojtur dhe shumë të nën-shërbyer.”*

Rrjedhimisht, ky qëndrim ndaj sistemit të mbrojtjes së fëmijës ndikon edhe qëndrimet e këtyre profesionistëve ndaj denoncimeve të dyshimta. Në këtë drejtim një profesioniste u shpreh:

“Unë po të isha p.sh. komshi do të hezitoja shumë për të bërë një denoncim. Pse t’ia prish fëmijës jetën? Duhet të jem shumë, shumë, shumë e sigurt, sepse ku do e çojnë këtë fëmijë?”

3.5 Gjetje nga Analiza e Rasteve Studimore: Menaxhimi i Rasteve të Fëmijëve Viktima të Abuzimit Seksual

Bazuar në vetë karakterin e seleksionimit (përzgjedhjes) *qëllimor* së këtyre rasteve (raste të ndjekura dhe të referuara nga NJMF-të), të dhënat e përftuara duhen konsideruar thjesht si *indikativë* dhe *jo përfaqësuese* në shkallë vendi për të gjitha rastet e abuzimit seksual të fëmijëve në rrethin e tyre të besimit. Në të vërtetë, këto të dhëna përbëjnë jo më shumë se 20% të të gjitha statistikave të raportuara në formularët e të dhënave administrative për qëllimet e këtij studimi. Gjithashtu, një element tjetër që duhet të merret parasysh është fakti se shumica e këtyre rasteve vijnë nga qarqe të caktuara të vendit, fakt i cili nuk mundëson domosdoshmërisht përgjithësimin e rezultateve në shkallë kombëtare.

¹ Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijës nënkupton të gjitha strukturat që menaxhojnë rastet e abuzimit të fëmijës, duke përfshirë këtu edhe organet e drejtësisë.

Duke patur parasysh konsideratat e lartpërmendura, më poshtë paraqiten përmbledhtazi gjetjet kryesore të gjeneruar nga ekstraktimi i informacionit nga këto raste ekzemplare të abuzimit seksual të fëmijëve në rrethin e tyre të besimit:

- Pothuajse të gjitha rastet ekzemplare (rreth 90%) konsistojnë në një profil social-ekonomik dhe psikologjik shumë të disfavourshëm të familjeve dhe të fëmijëve viktimë të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit.
 - Kështu, shumica e familjeve të viktimave i përkisnin segmenteve social-ekonomike vulnerabël të shoqërisë. Një pjesë e tyre jetonin në kushtet e papunësisë së të dy prindërve, ose të të ardhurave minimale nga 'vetëpunësimi' e shpeshherë ishin krejtësisht të marginalizuara për sa i takon aksesit ndaj shërbimeve sociale, arsimore dhe shëndetësore.
 - Disa raste (rreth 15%) i përkisnin komunitetit Rom, një pjesë e madhe e të cilit jeton në kufijtë e mbijetesës.
 - Nga ana tjetër, në rreth 50% të rasteve kishte evidencë të marrëdhënieve shumë të acaruara familjare dhe raste divorci për arsye të ndryshme ekonomike dhe sociale.
 - Gjithashtu, në 5-6 raste kishte evidencë të konflikteve të hapura mes bashkëshortëve të divorcuar, ku baballarët e viktimave nuk mbështesnin fare financiarisht fëmijët e tyre, ose i kishin humbur plotësisht kontaktet me familjen prej vitesh.
 - Rreth 30% e fëmijëve viktimë të abuzimit seksual në rrethin e tyre të besimit nuk frekuentonin shkollën, pavarësisht nga mosha e tyre e re.
 - Një pjesë e fëmijëve shfaqnin aftësi të kufizuara ose probleme të shëndetit mendor, të cilat siç rezulton edhe nga studime të tjera, i bëjnë më vulnerabël ndaj abuzimit seksual.

Në këtë kontekst të disfavourshëm social-ekonomik, emocional si dhe të marrëdhënieve konfliktuale familjare u verifikuan edhe shumica dërrmuese e rasteve ekzemplare të përfshira në këtë studim.

Për sa i përket identifikimit dhe menaxhimit të rastit, u vunë re karakteristikat, por edhe sfidat e mëposhtme të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, si dhe të fëmijëve e familjeve të përfshira, në këtë drejtim:

- Kontakti i parë (identifikimi, apo referimi) i fëmijëve viktimë të abuzimit seksual në rrethin e tyre të besimit i atribuohet (rreth 75%) sektorëve të ndryshëm të shërbimeve sociale si, Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF), qendrave rezidenciale, zyrave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), të cilat rezultuan që të ishin përfshirë menjëherë në menaxhimin e rasteve emergjente të fëmijëve në bashkëpunim me strukturat e policisë.
- Ndërkohë, rezultojnë edhe disa raste të bëra publike fillimisht në media dhe vetëm më pas janë bërë të dukshme për shërbimet sociale, edhe kur rastet kanë qenë në Tiranë, pra në zona të mbuluara më mirë nga shërbimet e nevojshme. Në këto raste të lidhura me rrjedhjen e informacionit, problemi qëndron në mos-referimin e rasteve nga policia, që më parë ia komunikon rastet medias se sa sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.
- Në të gjitha rastet ekzemplare të përfshira në këtë studim, referimi i rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve në rrethin e tyre të besimit, si hap i parë i procesit, është bërë brenda 24 orëve nga identifikimit të rastit, ose në ditën pasardhëse të punës.
- Por në rreth 25% të rasteve kanë qenë strukturat e Policisë së Shtetit që kanë marrë në mbrojtje fëmijët e dhunuar në rrethanat kur rastet e janë paraqitur jashtë orarit zyrtar të punës së NJMF-ve. Më pas, strukturat e policisë kanë bërë referimin e rasteve përkatëse pranë NJMF-ve dhe Shërbimeve Sociale Rajonale, por kjo jo gjithmonë ka ndodhur brenda kohës së parashikuar në Protokoll.

- Vlerësimi fillestar dhe më pas menaxhimi i rasteve është bërë në rreth 70% të rasteve nga NJMF-të si njësi përgjegjëse kryesore për këtë aspekt, por në bashkëpunim me institucione dhe organizata të ndryshme përfshi sektorin e shëndetësisë, shërbimin social dhe OJF-të.
- Në rreth 15% të rasteve, si agjenci kryesore të menaxhimit të rasteve kanë shërbyer qendrat rezidenciale. Në rreth 10% të rasteve institucioni kryesor i menaxhimit të rasteve ka qenë Shërbimi Social Shtetëror. Nga ana tjetër, në rreth 75% të rasteve agjencitë kryesore e menaxhimit të rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht në rrethin e tyre të besimit kanë qenë NJMF-të në bashkëpunim me OJF të ndryshme.
- Gjithashtu, duke konsideruar rezultatet e mësipërme, duhet theksuar se rezultojnë disa raste kur menaxhimi i rastit nuk është bërë nga NJMF-të e zonës, por nga sektorë të tjera të shërbimeve sociale, edhe pse ligjërisht është detyra dhe kompetenca e NJMF-ve që ta bëjnë këtë. Kjo ka ndodhur edhe në raste të identifikuar gjatë viteve 2014-2015, ku tashmë të paktën në çdo rreth ekzistojnë disa NJMF (ndonëse jo në të gjitha minibashkitë/zonat), të cilat mund të marrin përsipër ndjekjen e rastit.
- Shumica e rasteve (duke qenë se këto janë raste të identifikuar nga organizata) kanë marrë shërbim psikologjik për ndjekjen afatgjatë të fëmijës, por ky shërbim është ofruar gjithnjë nga organizatat joqeveritare mbështetëse, duke qenë se ai nuk mbulohet financiarisht/ose me personel nga strukturat shtetërore. Për arsye të ngjashme, edhe shërbimet mbështetëse për familjen rezultojnë të tilla.
- Në disa raste, rezulton se familjet për shkak të stigmës me të cilën ndeshen në komunitetet ku jetojnë, por edhe të përjetimit të tyre të ngjarjes si ‘turpërim para fisit e shoqërisë’, zhvendosen në komunitete të tjera, duke refuzuar jo vetëm shërbimin psikologjik afatgjatë të ofruar, por edhe ndjekjen ligjore të rastit, e cila në raste të tilla ka rezultuar të jetë ndërprerë. Ka dhe familje që kanë tentuar ‘vetëgjyqësinë’, duke u futur në hasmëri me njëra-tjetrën.

Në përfundim, gjetjet e mësipërme, ndonëse jo përgjithësuëse, janë indikativë të faktit se rastet që arrijnë të identifikohen nga sistemi i mbrojtjes së fëmijëve i përkasin më shumë familjeve në vështirësi ekonomike e sociale, ndonëse abuzimi seksual i fëmijëve brenda rrethit të besimit i përshkon të gjitha grupet e shoqërisë. Me sa duket, vetëm këto raste arrihen të identifikohen nga sistemi, siç evidentohet edhe nga komponentët e tjerë të studimit.

Sfida të tjera për sistemin rezultojnë edhe vështirësia në identifikim, marrja nga NJMF-të e rolit identifikues dhe menaxhues të rasteve, ndjekja ligjore e rastit kur familjet refuzojnë ta bëjnë këtë, si dhe ndjekja afatgjatë me shërbime psikologjike të specializuara, por edhe me shërbime mbështetëse për familjen.

3.6 Roli dhe Ndikimi i Medias në Fenomenin e Abuzimit Seksual të Fëmijëve në Shqipëri

Prezantimi në Media i Rasteve të Abuzimit Seksual të Fëmijëve

Pasqyrimi i rasteve të abuzimit seksual të fëmijës në media është i rëndësishëm dhe i dobishëm sepse ai ndërgjegjëson prindërit dhe gjithë shoqërinë për rreziqet potenciale që mund t’u kanosen fëmijëve në këtë drejtim dhe gjithashtu ndihmon në informimin e publikut mbi personat me rrezikshmëri për shoqërinë.

Profesionistët mendojnë se media ka rol të dyfishtë; ajo jo vetëm reagon dhe i përgjigjet kërkesave të audiencës së saj për informim dhe argëtim, por ndikon gjithashtu edhe në formimin e opinionit publik. Ata parashtruan një sërë problematikash lidhur mënyrën e prezantimit të rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve në media. Këto problematika paraqiten në mënyrë të grupuar më poshtë:

Fokusimi tek ngjarja sensacionale. Shumica e profesionistëve pohuan se media fokusohet tek ngjarja duke mos pasqyruar sistemin. Kryesisht trajtohen vetëm rastet ekstreme. Ajo fokusohet në abuzimet ku dhuna dhe perversiteti janë në formën maksimale, kur ka diferencë të madhe moshe mes fëmijës dhe abuzuesit, kur janë të përfshirë familjarë dhe persona të afërt, apo kur abuzimet janë me natyrë homoseksuale. Disa nga gazetarët u shprehën:

“Ka stereotype në mënyrën që mund të trajtohen, p.sh. nëse është një 16-vjeçar me një 14-vjeçare nuk do merrte dhe aq shumë kohë/hapësirë në media... nuk është në interesin tonë sepse nuk përbën lajm... për ne sa më i keq lajmi aq më mirë”

Trajtimi i lajmit është sipërfaqësor, pa u futur në thellësi tek ndërhyrja në nivel sistemi apo fenomeni social. Gjithashtu ajo nuk përpiket të sensibilizojë publikun rreth fenomenit.

Pasqyrimi i ndihmës së ofruar për mbrojtjen e fëmijës. Sipas profesionistëve sistemi i mbrojtjes së fëmijës nuk pasqyrohet në media dhe sidomos shërbimet sociale. Ata u shprehën:

“Më shumë shfaqet policia dhe pastaj si u gjykua, d.m.th. fillimi dhe fundi. Nuk flitet për psikologë dhe punonjës socialë. Njerëzit nuk e marrin vesh se ka dhe struktura të tjera përveç policisë që t’i dinë dhe të denoncojnë dhe ata nëse duhet sepse njerëzit kanë frikë të shkojnë në polici”

Për shumicën e gazetarëve sistemi i mbrojtjes së fëmijës nuk është i dukshëm. Ata e konsiderojnë atë pak prezent në procesin e denoncimit të rastit dhe nuk kanë njohuri lidhur me përfshirjen e tij në ndjekjen e mëtejshme të fëmijës. Sipas gazetarëve sistemi nuk është efektiv në ofrimin e shërbimeve që i nevojiten fëmijës dhe nuk përgjigjet jashtë orarit zyrtar.

Gazetarët evidentuan se ekzistenca e një sistemi efektiv të mbrojtjes së fëmijës do të ndikonte edhe në cilësinë e raportimit të rasteve të abuzimit nga media. Një koment i tyre ishte:

“Shpeshherë, për të shkruar lajmin në gazetë duhen mbushur rreshtat, edhe kur informacioni është i pakët. Nga del ky informacion? Shpiket nga gazetarët për të mbushur kolonën e gazetës, duke çuar në keq-raportim. Nëse shërbimi policor, shërbimet sociale dhe shëndetësore do të funksionin siç duhet dhe do të bashkëpunonin, atëherë kjo do ndikonte në dhënien më të plotë dhe shumë më të vërtetë të ngjarjes.”

Shtrembërimi dhe erotizmi i informacionit. Sipas profesionistëve të sistemit të mbrojtjes së fëmijës media ekzagjeron në raportimin e rasteve. Gjuha e përdorur prej saj është e papërshtatshme. Gjithashtu, profesionistët e medias u shprehën se ata shpesh e manipulojnë lajmin e abuzimit seksual të fëmijës duke theksuar dhe ekzagjeruar detaje të cilat i japin ngjyrim

erotik apo pornografik lajmit. Ata u shprehën se: “Shkrimet në media bëhen sa më pornografike të jetë e mundur në mënyrë që të tërheqin lexuesin.”, apo se: “Media i shndërron këto ngjarje në reklamë erotike dhe perversiteti duke dhunuar etikën.”

Dhunimi i privatësisë. Megjithëse ka pasur përmirësime në këtë drejtim dhe fëmijët nuk jepen më me pamje dhe emër të plotë, përsëri mbetet problematik fakti që media jep të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e fëmijëve të abuzuar seksualisht. Jepen inicialet, vendbanimi, pamje të shtëpisë, prindërve dhe familjarëve. Një gazetar/e pohoi:

“Privatësi nuk ka, pasi ta kërkon shefi identitetin e viktimës dhe/ose agresorit.”

Në nga prindërit e intervistuar për këtë studim pohoi se fëmija doli me emër, figurë dhe vendbanim në televizor dhe në të gjitha mediat. Të gjitha të dhënat identifikuese për të u dhanë në media. Edhe pse në fillim prindërit dhe familjarët e konsideruan prezencën dhe ndikimin e medias si shumë pozitiv, pas disa vjetësh nga abuzimi dhe mediatizimi i tij, fëmija vazhdon të përndiqet nga ngjarja. Të dhënat dhe historia e abuzimit të fëmijës janë të aksesueshme online dhe keqpërdoren nga të njohurit në komunitetin ku jeton fëmija për t’u tallur me të. Duket se publikimi i abuzimit nuk ka ndikuar në rritjen e sensibilizimit të komunitetit siç edhe ai shpresonte, por përkundrazi, është shndërruar në burim abuzimi të mëtejshëm.

Ndonëse fëmija dhe familja e tij e konsideruan fillimisht ndihmues rolin e medias në publikimin e rastit për të marrë më shumë vëmendje dhe ndihmë nga sistemi, aktualisht ai po vuan pasojat e këtij impakti.

Gjatë intervistës, nëna e fëmijës pohoi:

“Një tjetër vështirësi shume e madhe, me të cilën hasemi përditë, është fakti që lajmi i ngjarjes vazhdon të jetë online dhe kjo duhet të hiqet sepse këtu në fshat e lexojnë të tjerët dhe ja kujtojnë djalit ngjarjen duke e vënë në siklet dhe dëshpërim!”

Fokusimi tek viktima dhe jo tek pasqyrimi i të gjitha fakteve. Në mjaft raste media fokusohet tek viktima dhe familja e tij, ndërkohë që flitet pak për abuzuesin. Për më tepër, media është e njëanshme dhe tenton të favorizojë fëmijët ose gratë gjatë dhënies së lajmeve.

Publikimi i rasteve nga burime jo të konfirmuara dhe atribuimi i fajit. Media shpesh portretizon personin e pandehur si abuzues, pa pritur për konfirmimin e lajmit. Gjithashtu, gazetarët u shprehën se ata zakonisht nuk i rikthehen lajmit për ta përgënjeshtuar kur akuzat kanë qenë të pabazuara. Disa nga komentet e tyre ishin:

“Ne e marrim të mirëqenë se është autori.”, ose: “Nuk e kemi prezumimin e pafajësisë, për ne shpallet fajtor.”

Rrjedhja e informacionit. Dy nga prindërit e intervistuar pohuan se informacioni rreth rastit të tyre kishte dalë në media pasi ata kishin bërë denoncimet në polici. Ato u shprehën:

“Ka dalë në media me emër dhe me mbiemër dhe njerëzit më kanë bezdisur... Nuk e di si doli... por nuk kisha fuqi të merresha dhe me këtë.”

“Nuk e di kush e lajmëroi median, ndoshta policia. U mbyllëm në shtëpi dhe më pas erdhën gazetarët.”

Sipas profesionistëve, shpesh lajmet për rastet e abuzimit seksual bëhen publike nëpërmjet medias, pasi ka patur rrjedhje të informacionit nga organet e policisë, prokurorisë dhe gjykatës.

“Gazetarët këto raste ndjekin dhe rrinë gjithë kohën në komisariate e prokurori në ndjekje të lajmit. Duhet një akt normativ për gazetarët lidhur me mënyrën e raportimit të këtyre rasteve.”

Frika për të denoncuar mediat. Vetë profesionistët e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës duhet t’i denoncojë mediat që nuk respektojnë të drejtat e fëmijës, por ata u shprehën se nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Arsyeja kryesore është frika dhe pasiguria për t’u konfrontuar me median, kryesisht ato më të fuqishme.

Censurimi i të pasurve. Në përgjithësi rastet e abuzimit seksual të fëmijëve të pasqyruara në media i përkasin familjeve të varfra të cilat janë të pambrojtura. Familjet e pasura dhe me ndikim ndërhyjnë dhe lajmi censurohet nga drejtuesit e medias. Një gazetar u shpreh:

“Të pasurit nuk lejojnë që lajmi të bëhet publik. Është kryeredaktori ai/ajo që censuron lajmin, dhe duhet të bindesh. Përndryshe mund të mbetesh pa punë.”

Përdorimi i rastit për të zhvendosur vëmendjen e publikut. Problematike gazetarët konsideruan edhe mundësinë e përdorimit të rasteve të abuzimit të fëmijëve për të zhvendosur vëmendjen e publikut nga çështje të tjera, për të cilat drejtuesit e mediave nuk dëshirojnë të ketë vëmendje. Një gazetar/e pohoi:

“Kryeredaktorët i përdorin rastet e abuzimit seksual të fëmijëve që bëjnë bujë edhe për të tërhequr vëmendjen nga probleme të tjera më të mëdha.”

Politizimi i rastit. Disa profesionistë theksuan se media është e politizuar dhe e pasqyron në mënyrë të politizuar rastin e abuzimit dhe mënyrën se si ai trajtohet nga sistemi.

Shkaqet e Pasqyrimin Problematik nga Gazetarët

Drejtuesit jo profesionalë. Gazetarët përmendën mungesën e njohurive të drejtuesve të medias mbi gazetarinë si një nga arsyet kryesore që ndikon në pasqyrimin e papërshtatshëm në media të rasteve të abuzimit seksual të fëmijës. Ata pohuan se pak reflektohet nga drejtuesit e medias

mbi rolin edukues dhe sensibilizues të saj duke qenë se në shumicën e tyre drejtuesit nuk e njohin profesionin e gazetarit dhe, për më tepër, e shfrytëzojnë median për interesat e bizneseve të tjera personale.

Gazetarët jo profesionalë. Një shkak tjetër i përmendur lidhet me mungesën e njohurive dhe profesionalizmit të gazetarëve të kronikës.

“Gazetarët e kronikës nuk janë profesionistë dhe raportimi i ngjarjes nga ta bëhet në mënyrë të gabuar.”

Preferencat e publikut për lajme sensacionale. Disa profesionistë pohuan se publiku ndahet në kategori, ku një pjese i intereson mënyra se si është adresuar problemi, por pjesës më të madhe sipas tyre u intereson ngjarja. Ata u shprehën:

“Mediat e kanë të qartë se çfarë do publiku, telenovela, prandaj japin detaje të shumta dhe e bëjnë më interesante.”

Të të njëjtit mendim janë edhe gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias. Sipas tyre publiku ndjek dhe kërkon lajme sensacionale dhe rrjedhimisht media i përgjigjet duke dhënë lajmet mbi abuzimin seksual të fëmijëve në formë të ekzagjeruar.

“Ka uri nga publiku për lajme sensacionale, për lajme të kronikës së zezë, ose publiku shtyhet për të lexuar dhe ka kërshtëri për të mësuar mënyrën e përdhunimit. Publiku do energji negative.”

Duket se nga të gjithë profesionistët besohet se publiku në përgjithësi ka një interes të lartë për ngjarjet e abuzimit seksual të fëmijëve, të cilat pasqyrojnë historinë personale të fëmijës apo të abuzuesit, të viktimizimit të tyre, të cilat lidhen me kuriozitetin dhe interesin për argëtim se sa me ndjenjën e sensibilitetit, empatisë apo qëndrimin qytetar për të reaguar ndaj fenomenit apo çështjes në përgjithësi.

Mungesa e monitorimit dhe e pasojave të shkeljes së kodit etik. Kodi etik i gazetarit duket se nuk përbën aktualisht ndonjë standard lidhur me raportimin e lajmit. Ai nuk monitorohet dhe nuk ka penalizime për moszbatimin e tij. Gazetarët përmendën:

“Është një kod i brendshëm, por s’është gjithmonë i njohur apo i zbatuar. As nuk ka pasur ndonjëherë dhe nuk ka penalitete në rastet e shkeljes së tij.”

Gjithashtu:

“...kush e vlerëson zbatimin e kodit etik? Nuk kemi sindikata, nuk ka urdhër të gazetarëve. Edhe Unioni i Gazetarëve nuk arriti të sigurojë një mbrojtje të gazetarëve të rrezikuar.”

Interesat e biznesit. E ushtruar si një biznes në funksion të bizneseve të tjera të drejtuesve, media ka qëllim dhe funksione të ndryshme nga ato që duhet të ketë, dhe ndjek agjenda të ndryshme. Në lidhje me këtë një gazetar/e u shpreh:

“Në Tiranë rastet e abuzimit seksual të fëmijëve humbasin ngaqë drejtuesit e medias kanë kapitalet dhe bizneset e tyre dhe e përdorin median që drejtojnë për interesin e tyre, duke mos raportuar rastet e abuzimeve me fëmijët, por duke preferuar të mbulojnë aktivitetin e politikanëve dhe institucioneve të ndryshme.”

Dhunimi i gazetarëve nga drejtuesit e medias. Në shumë raste gazetarët u shprehën se ndiheshin të trysnuar nga drejtuesit e tyre. Rrjedhimisht ata e pasqyronin lajmin sipas kërkesave të drejtuesit, ose në disa raste ishin këta drejtues që ndryshonin lajmin duke ia lënë autorësinë gazetarit. Lidhur me pasqyrimin jo të përshtatshëm të rasteve të abuzimit seksual të fëmijës, një gazetar/e u shpreh:

“S’ është se ne e bëjmë me qejf, sepse edhe ne e dimë se çfarë pasojash mund të sjellë kjo për familjet dhe për fëmijën... por në praktikë bëjmë dhe ne kompromiset tona.”

Natyra e punës. Çështje të tjera që lidhen me natyrën e lajmit dhe punës së medias ndikojnë në pasqyrimin e papërshtatshëm të rastit të abuzimit seksual të fëmijës siç është p.sh. koha e shpejtë e përgatitjes dhe dhënies së lajmit, e cila ndikon në uljen e cilësisë.

Mungesa e ndërgjegjësimit të prindërve. Një shkak tjetër i përmendur i pasqyrimin problematik në media të rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve ishte edhe mungesa e ndërgjegjësimit të prindërve për rolin dhe impaktin që do të ketë pasqyrimi në media i rastit të abuzimit të fëmijës së tyre. Ndërkohë që prindërit kërkojnë të gjejnë tek media një aleat që do t’i ndihmojë, sipas gazetarëve, është detyrë e prindërve që t’i mbrojnë fëmijët nga ata. Njeri/a prej tyre pohoi:

“Por duhet dhe ndërgjegjësimi i prindërve. Ata duhet të kuptojnë se nuk duhet të na japin aq shumë informacion, sepse dihet që ne për atë punë shkojmë.”

Ndikimi i Medias

Ulja e numrit të denoncimeve. Disa gazetarë përmendën influencën që ka pasqyrimi i papërshtatshëm në media i rasteve të ASF në ngurrimin dhe refuzimin e viktimave për të denoncuar abuzimin. Ata u shprehën:

“Përveç mentalitetit që pengon zbatimin e ligjit, është abuzuar dhe me rastet e publikuara, duke bërë që viktimat e tjera të tërhiqen, të tremben dhe të mos marrin guximin të denoncojnë në të ardhmen.”

Stigmatizimi i viktimës. Duke qenë se lajmet mbi abuzimin seksual të fëmijës erotizohen dhe janë njëkohësisht të fokusuar tek viktima, ato mund të përforcojnë paragjykimet dhe normat sociale të stigmatizimit të viktimës. Rrjedhimisht, kjo formë raportimi nuk nxit empatinë dhe mbështetjen

nga ana e shoqërisë, por ndikon në izolimin dhe diskriminimin e viktimave. Një gazetar përmendi reagimin e një prindi pas shtrembërimeve në raportimin e lajmit:

"... lajmi për ngjarjen doli në media, por duke futur në intervistë apo në kronikë dhe fjalë që nuk ishin thënë nga viktimja, madje me fjalë të ndyra dhe të padenja për mediat. Në këto kushte, i ati i viktimës thoshte që: - po ma vrisni djalin për së dyti."

Stigmatizimi i të akuzuarit si abuzues. Duke qenë se gazetarët pohuan se nuk i rikthehen rastit dhe zakonisht është tendenca për t'ia atribuar fajin të akuzuarit gjatë raportimit, është e mundur që persona të akuzuar padrejtësisht të paragjykoen dhe stigmatizohen në shoqëri. Një pjesë e gazetarëve pohuan gjithashtu se as ata vetë nuk i ndjekin rastet dhe nuk janë në dijeni të vërtetimit ose jo të fajësisë për personat e akuzuar si abuzues.

Keqedukimi i publikut. Media ka qenë pak e orientuar drejt edukimit dhe sensibilizimit të publikut lidhur me çështjen e abuzimit seksual të fëmijëve. Por duke qenë se këto funksione janë pjesë e pandashme e shërbimit që ajo ofron, publiku është keqedukuar në vend që të edukohet. Për profesionistët e medias kurioziteti dhe argëtimi janë motivet kryesore që drejtojnë publikun drejt ndjekjes së rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve dhe ata i përshtaten këtyre kërkesave. Ata supozojnë se prezantimi i rasteve nga media do të ishte i ndryshëm nëse publiku do të perceptohej më empatik dhe mbështetës ndaj viktimës, apo më i shqetësuar ndaj fenomenit. Pra, jo vetëm media ka formuar ose mund të formojë qëndrimet e publikut ndaj fenomenit, por edhe vetë publiku dikton deri në një farë mase mënyrën e raportimit për këtë çështje.

Është për t'u theksuar se një nga treguesit kryesorë të përmendur për vlerësimin e impaktit të medias në publik ishte numri i shikimeve dhe komenteve online. Duke qenë se ky është një burim pak i besueshëm apo jo i përgjithësueshëm informacioni, është e vështirë të analizohet nëse media në vetvete është mjaftueshëm e informuar mbi perceptimet e publikut lidhur me këtë çështje.

IV. Përfundime dhe Rekomandime

4.1 Përfundimet Kryesore të Studimit

Fenomeni i Abuzimit Seksual të Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri

Ky studim, duke qenë i pari që trajton abuzimin seksual tek fëmijët brenda rrethit të tyre të besimit, sjell gjetje interesante dhe mjaft të rëndësishme për politikë-bërësit dhe vendimmarrësit e përfshirë në hartimin dhe zbatimin e reformave të politikave sociale në Shqipëri.

Edhe pse studimi nuk kishte si qëllim të vlerësonte nga ana sasiore peshën që zë abuzimi seksual i fëmijëve brenda rrethit të besimit, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në studim (profesionistë, prindër, fëmijë) pohuan se abuzimi seksual brenda rrethit të besimit është forma më e hasur e abuzimeve seksuale tek fëmijët. Analiza e fokus grupeve si dhe ajo sasiore konfirmoi faktin që abuzimet seksuale tek fëmijët ndodhin nga njerëz që ata i njohin mirë, që kanë fituar besimin e fëmijës dhe zakonisht në mjedise të njohura për fëmijët.

Përgjithësisht profesionistët mendonin se abuzimi seksual i fëmijëve brenda rrethit të besimit mund të ndodhë tek çdo fëmijë, pavarësisht moshës, gjinisë, gjendjes social-ekonomike, arsimimit, etj. Analiza sasiore e studimit nxori në pah profilin e fëmijëve që ishin abuzuar. Pothuajse të gjitha rastet ekzemplare (rreth 90%) konsistonin në një profil social-ekonomik dhe psikologjik shumë të disfavorshëm të familjeve dhe të fëmijëve viktime të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit. Interesant ishte fakti që abuzimet seksuale brenda rrethit të besimit kishin ndodhur jo vetëm tek vajzat, por edhe tek djemtë. Ky fakt duhet eksploruar më në thellësi pasi, përgjithësisht dhe konvencionalisht, pranohet se abuzimi seksual në rrethin e besimit ndodh më shumë tek vajzat.

Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët që vijnë nga shtresa në nevojë u konsideruan si grupet më të brishta, tek të cilët mund të hasen me shpesh forma të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit.

Studimi tregoi se në përgjithësi mungojnë të dhënat sistematike dhe koherente sa i përket rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht dhe në veçanti të atyre brenda rrethit të besimit.

Për rrjedhojë, një nga sfidat kryesore për të përcaktuar karakteristikat, prevalencën dhe shkallën e fenomenit është mungesa e të dhënave të sakta statistikore mbi rastet e abuzimit seksual të fëmijëve në tërësi dhe ato që ndodhin brenda rrethit të tyre të besimit në veçanti. Problematikat mbi regjistrimin e rasteve lidhen me mungesën e indikatorëve të unifikuar mbarëkombëtarë, mungesën e një sistemi standard të monitorimit të rasteve dhe faktin se struktura të ndryshme kanë databaza të ndryshme.

Si rezultat është shumë e vështirë, për të mos thënë gati e pamundur, të nxjerrësh konkluzione të bazuara në fakte dhe shifra mbi këtë fenomen. Mungesa e të dhënave të sakta mbi abuzimin seksual të fëmijëve në rrethin e besimit, sjell pasoja negative në të gjitha hallkat e sistemit, sa i përket mungesës së hartimit të politikave, programeve, burimeve dhe shërbimeve të domosdoshme për fëmijët.

Normat Sociale dhe Roli i Medias

Studimi evidentoi një sërë normash sociale që e përforcojnë mungesën e përgjithshme të reagimit ndaj fenomenit të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit. Në përgjithësi, ekzistenca e dhunës si normë shoqërore pengon individët për të identifikuar, referuar, apo për të ofruar mbështetje dhe shërbime, si rezultat i pragut më të lartë të ndjeshmërisë individuale dhe kolektive ndaj fenomenit.

Sipas pjesëmarrësve në studim, mbizotëron ende mendësia se “çfarë ndodh brenda familjes, mbetet brenda familjes”, që vlerëson si të shenjtë privatësinë e familjes, ushqen sekretin dhe heshtjen, stigmatizon fëmijët viktime të abuzimit seksual dhe bën që profesionistët, prindërit dhe fëmijët të hezitojnë ta raportojnë atë. Përgjithësisht nga profesionistët u pohua se modeli shoqëror sipas të cilit familja shqiptare ende mund të mbështetet në një rreth të gjerë besimi për mirërritjen dhe kujdesin e fëmijëve, përfshi familjen e gjerë, të njohurit, miqtë, fqinjët, etj, mund të përbëjë edhe rrezikun më të madh për fëmijët pasi shpesh prindërit mbeten të pavëmendshëm ndaj shenjave të mundshme të abuzimit brenda këtij rrethi besimi.

Normat patriarkale dhe diskriminimi gjinor brenda familjes i bën vajzat në përgjithësi, dhe sidomos ato mbi 14 vjeç në veçanti, më të cenueshme nga paragjykimi dhe stigmatizimi pasi ekziston qëndrimi “se e kanë kërkuar vetë”, duke i bërë të ndihen fajtoreshë për çfarë ka ndodhur. Ndërkohë që identifikimi dhe raportimi i rasteve të abuzimit seksual tek djemtë bëhet akoma më i vështirë, pasi ai është i papranueshëm dhe i pabesueshëm për shkak të perceptimit të rolit të djalit në shoqëri.

Mbi të gjitha, fëmijët viktime të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit bëhen objekt i stigmës. Stigmatizimi është i dyfishtë: nga familja dhe nga shoqëria. Një situatë e tillë, jo vetëm që shkakton viktimizimin e shumëfishtë të fëmijës që ka rënë pre e këtij abuzimi, por ai frenon edhe mundësinë e denoncimit të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit, duke bërë që në polici të denoncohen vetëm rastet më të rënda.

Për rrjedhojë denoncimi i rasteve të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit mbetet në një shkallë shumë të ulët. Arsyet kryesore përveç stigmës në shoqëri, konsiderohen niveli i ulët i ndërgjegjësimit dhe informacionit të prindërve dhe kujdestarëve të tjerë mbi ekzistencën e abuzimit seksual të fëmijëve në rrethin e besimit. Për rrjedhojë prindërit dhe profesionistët e tjerë bëjnë shumë pak për të informuar fëmijët mbi kujdesin dhe mbrojtjen që duhet të kenë për veten dhe janë të pavëmendshëm ndaj shenjave, duke i lënë fëmijët në një rreth shumë të gjerë dhe të patektuar besimi që bëhet predispozitë për abuzimin.

Lidhur me rolin që ka media në trajtimin e rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit, përgjithësisht u pranua që media duhet të ketë një rol ndërgjegjësues dhe në formimin e opinionit publik mbi rreziqet potenciale që mund t’u kanosen fëmijëve në këtë drejtim. Përgjithësisht pranohet se media i trajton këto raste në mënyrë jo etike dhe profesionale, duke dhunuar të drejtat e fëmijës për mbrojtje dhe privatësi dhe në shumë raste duke e shtrembëruar informacionin. Mungesa e monitorimit efektiv të mediave nga strukturat përkatëse, si edhe niveli i ulët profesional i gazetarëve dhe drejtuesve të mediave sa i përket mbulimit të kësaj çështje paraqiten si shkaqet kryesore të kësaj problematike. Pasqyrimi sensacional i lajmeve mbi rastet e abuzimit seksual të fëmijëve, pa përgjegjësi dhe në formë të shtrembëruar, përforcon stigmën në shoqëri, ndikon në numrin e ulët të denoncimeve nga prindërit apo dhe vetë fëmijët, si edhe çon në keqedukimin e publikut.

Përgjigjja e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve ndaj Abuzimit Seksual në Rrethin e Besimit

Bazuar në gjetjet e studimit, sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri përballet me shumë sfida, të cilat duhen marrë në konsideratë gjatë hartimit të politikave dhe ndërhyrjeve për parandalimin e abuzimit seksual të fëmijëve në rrethin e besimit dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Mungesa e masave parandaluese. Studimi tregon se mungojnë tërësisht masat parandaluese për ndërgjegjësimin dhe informimin e të gjithë aktorëve që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët, duke filluar nga prindërit dhe familja, mbi ekzistencën e abuzimit seksual të fëmijëve në rrethin e besimit. Profesionistët dhe media nuk kontribuojnë siç duhet në parandalim për shkak të mungesës së kapaciteteve profesionale dhe kompetencave për të trajtuar problemin, mungesës së materialeve edukuese dhe informuese miqësore për fëmijët, familjet dhe komunitetin, si edhe mungesën e përgjegjësisë dhe etikës profesionale në trajtimin e rastit.

Perceptimi i ngushtë i rrethit të besimit. Shumica e profesionistëve dhe prindërve që morën pjesë në këtë studim shfaqën të kuptuar të ndryshëm mbi rrethin e besimit. Ky studim gjeti se koncepti dhe perceptimi i “rrethit të besimit” në përgjithësi ishte shumë i ngushtë. Përgjithësisht të gjithë pjesëmarrësit e perceptojnë rrethin e besimit si “rrethi i ngushtë familjar”, i përbërë tipikisht nga prindërit, vëllezërit ose motrat më të rritura ose kushërinjtë dhe personat më të afërm të familjes si gjyshërit, xhaxhallarët, etj. Ideja e përgjithshme se abuzuesit në pjesën më të madhe të rasteve janë persona brenda rrethit të besimit të fëmijëve dhe perceptimi shumë i ngushtë mbi rrethin e besimit, shoqërohet me rrezikun që prindërit apo kujdestarët e fëmijët të ulin “vigjilencën” dhe të shfaqin më pak kujdes ndaj personave që nuk janë pjesë e familjes, por që në fakt janë në kontakt të vazhdueshëm me fëmijën dhe rrjedhimisht fitojnë besimin e tij ose të saj si persona “të sigurt”. Të tillë shembuj mund të ishin miqtë e prindërve ose të familjes, fqinjët që shfaqen dashamirës dhe të sjellshëm me prindërit dhe fëmijët apo profesionistë të ndryshëm si mjeku i familjes, mësuesi, etj.

Mangësi në Identifikimin e Hershëm. Nga studimi u konstatua se strukturat që kanë rol në identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje (të tilla si: policia, shërbimi social, strukturat arsimore dhe shëndetësore), si dhe në referimin e tyre pranë NJMF-së, nuk e kryejnë rolin e tyre. Në veçanti shkolla perceptohet si jo e afërt me fëmijët, sa i përket figurës së psikologut dhe mësuesve në përgjithësi, të cilët nuk u panë si të aksesueshëm dhe ndihmues në të tilla raste. Gjithashtu NJMF-ja përgjithësisht nuk e kryen rolin e saj në identifikimin e fëmijëve në rrezik për abuzim. Zakonisht NJMF-ja lajmërohet nga policia pasi rasti është denoncuar ose nëse rasti ka dalë në media.

Mos-raportimi i rasteve nga profesionistët. Përgjithësisht profesionistët kanë frikë dhe refuzojnë të implikohen për të raportuar dhe referuar raste të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit. Ata pohuan se kushti për të bërë kallëzim penal në polici, në mënyrë që policia të nisë hetimin për çfarëdolloj dyshimi që ata mund të kenë, i bën ata të ndihen të pasigurt. Nga njëra anë, kjo pasiguri vjen si pasojë e kërcënimeve nga abuzuesit apo familjarët e tyre dhe nga ana tjetër nga mungesa e mbrojtjes nga shteti. Rrjedhja e informacionit/humbja e konfidencialitetit, raportimi i papërshtatshëm në media dhe stigmatizimi i viktimës shfaqen si arsye më madhore të mosdenoncimit të rasteve të abuzuara seksualisht brenda rrethit të besimit nga profesionistët.

Mungesa e shërbimeve të emergjencës. Shërbimet mbështetëse për fëmijët e abuzuar seksualisht janë shumë të pakta. Problemi më i madh i evidentuar ishte mungesa e qendrave të emergjencës, apo shërbimeve të tjera ku fëmija të mund të referohet për të marrë ndihmën e menjëhershme.

Shërbimet shëndetësore nuk kanë mjedise të veçanta dhe miqësore për të trajtuar fëmijët e abuzuar seksualisht (si psh., ekzaminimi gjinekologjik, etj.), si edhe nuk ka fonde për të mbuluar shpenzimet e ndihmës emergjente si shërbimin psikologjik, apo shërbime të tjera për ndihmën e menjëhershme dhe marrjen në mbrojtje të fëmijës.

Mungesa e ndihmës së specializuar, afatgjatë dhe të rehabilitimit. Pas kapërcimit të fazës emergjente fëmijët e abuzuar seksualisht, por edhe familjarët e tyre mbeten në situatë të vështirë dhe me shumë nevoja të paplotësuara. Nevojat ekonomike, për mbështetje psikologjike dhe siguri plotësohen minimalisht nga sistemi i mbrojtjes së fëmijës. Profesionistët konstatojnë mungesën e shërbimeve mbështetëse dhe atyre të specializuara për fëmijët e abuzuar seksualisht dhe familjarët e tyre. Fëmijët e abuzuar seksualisht dhe prindërit e tyre përballen me diskriminimin, përbuzjen dhe talljen nga bashkëmoshatarët dhe komuniteti, për të cilët shkolla apo edhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor nuk marrin masa për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe trajtimin e traumës së fëmijës.

Viktimizimi i shumëfishtë i fëmijës nga vetë profesionistët. Profesionistët në këtë studim pohojnë se shumë shpesh komunikimi me fëmijët e abuzuar seksualisht që vihen në kontakt me autoritetet dhe shërbimet e ndihmës është i papërshtatshëm. Profesionistët dhe fëmijët kanë përmendur raste ku ata janë trajtuar pa respekt nga mjeku që i ka vizituar, apo se janë diskriminuar nga psikologu. Për më tepër fëmija mund të merret disa herë në pyetje nga profesionistë të ndryshëm, duke shkaktuar ri-përjetim të traumës. Mungesa e psikologut në komisariate ose marrja në punë e personave pa formimin përkatës në rolin e psikologut bën që fëmijët të merren në pyetje pa praninë e psikologut, dhe për rrjedhojë dëshmia të konsiderohet e pavlefshme. Fëmijët dhe familjarët e tyre shfaqën zhgënjim dhe pasiguri nga dënimet e ulëta të dhëna autorëve nga gjykatat.

Përveç problemeve dhe mangësive që lidhen specifikisht me çështjen e abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit, ky studim pati edhe një sërë gjetjesh që lidhen me çështjet e funksionimit dhe strukturës aktuale të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.

Megjithëse ka përmirësime të vazhdueshme në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, ende ka shumë vështirësi që duhet të merren në konsideratë, të tilla si:

- **Mangësi në kuadrin ligjor.** Me gjithë përmirësimet në kuadrin ligjor për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, neglizhimi, dhuna dhe shfrytëzimi në përgjithësi dhe rishikime ligjore për ashpërsimin e masave të dënimit për abuzuesit, legjislacioni shqiptar ka ende mangësi sa i përket çështjes së abuzimit seksual të fëmijëve. Monitorimi i zbatimit të Konventës së Lanzarotës tregon se përcaktimi më i saktë i krimit të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit, duke e përafëruar atë me përcaktimin e Konventës së Lanzarotës është i domosdoshëm. Gjithashtu, ky përcaktim duhet të përfshijë të gjithë personat e mundshëm që mund të abuzojnë me pozitën e tyre të besimit, autoritetit ose të ndikimit (si p.sh. rrethi shoqëror i anëtarëve të familjes, një fqinj, etj.). Ky raport evidenton nevojën për një analizë më të thelluar të kuadrin ligjor për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, e cila duhet të paraqesë mangësitë dhe nevojën për përmirësime ligjore, si dhe të përbëjë një bazë të vlefshme për hartimin e ligjeve dhe akteve nën ligjore të reja, politikave dhe ndërhyrjeve për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual.

- **Numri i kufizuar i burimeve njerëzore** që punojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve. Konkretisht, *mungesa e NJMF-ve* në çdo njësi administrative në Shqipëri si dhe prania e vetëm e një punonjësi në NJMF-të ekzistuese, e vështirëson shumë punën në identifikimin, referimin, vlerësimin dhe ndjekjen e rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit. *Mungesa e pranisë së vazhdueshme të psikologut* në shkolla, për shkak të numrit të kufizuar të tyre bën që fëmijëve dhe të rinjve t'u mungojë mbështetja e vazhdueshme psikologjike, e cila do t'i ndihmonte ata për të parandaluar apo kapërcyer situatat e vështira. *Numri i kufizuar i psikologëve* që ofrojnë shërbimin e tyre pranë organeve të rendit në rastet e abuzimit seksual të fëmijëve, vështirëson vlerësimin fillestar të rastit brenda afateve të përcaktuara kohore të përshkruara në Udhëzimin Ndërmintor për Mbrojtjen e Fëmijës.
- **Mungesa e njohurive dhe aftësive profesionale të profesionistëve.** Studimi arrin në përfundimin se profesionistët nga sektorë të ndryshëm që punojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve kanë mangësi në njohuri dhe në aftësi profesionale lidhur me trajtimin e rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit. Një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk janë përfshirë në programe trajnimi që lidhen me çështje të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit. Nga ana tjetër, një pjesë e tyre nuk njohin plotësisht kuadrin e përgjithshëm rregullator mbi menaxhimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar, specifikat e vlerësimin dhe ndjekjes së rasteve të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit. Kodi i sjelljes së profesionistëve me fëmijët është në mjaft raste i papërshtatshëm.
- **Mungesë bashkëpunimi midis institucioneve** dhe strukturave të përfshira në trajtimin e rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve. Edhe pse kuadri rregullator i menaxhimit të rasteve të abuzimit të fëmijëve qartëson detyrimin që kanë të gjithë institucionet përgjegjëse për të bashkëpunuar midis tyre, përsëri haset vështirësi në arritjen e këtij bashkëpunimi. Sidomos mungon bashkëpunimi me sektorin shëndetësor dhe arsimor, të cilët përgjithësisht luajnë rol pasiv në trajtimin e rasteve të abuzimit seksual tek fëmijët brenda rrethit të besimit. Nga ana tjetër, *mungesa e përshkrimeve të posaçme të punës* për profesionistët e shërbimeve të mbrojtjes, shkakton paqartësi, shpeshherë mbingarkesë dhe mbivendosje rolesh, që zbeh përgjigjen e sistemit dhe të shërbimeve ndaj rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve.
- **Mungesa e fondeve dhe infrastrukturës së përshtatshme** pengon zbatimin, monitorimin dhe ndjekjen e rastit. Shpeshherë, punonjësi i NJMF-së e ka të vështirë të monitorojë dhe ndjekë rastin e raportuar për arsye të burimeve financiare të kufizuara për të mbuluar kostot e transportit apo të komunikimit. Shpeshherë këto vështirësi tejkalohen nëpërmjet kontributit të shoqërisë civile apo strukturave të tjera private që operojnë në zonë. Gjithashtu mungesa e fondeve konsiderohet si arsyeja kryesore për mungesën e qendrave të emergjencës dhe shërbimeve të specializuara për trajtimin e fëmijëve të abuzuar seksualisht.

4.2 Rekomandimet

Nisur nga gjetjet dhe konkluzionet e këtij studimi cilësor lind nevoja e marrjes së masave për ndërhyrje të menjëhershme dhe të qëndrueshme në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, që do të ndikonin në përmirësimin e parandalimit dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual në rrethin e besimit në Shqipëri. Këto rekomandime janë grupuar si më poshtë:

Ngritja e Mekanizmave për Parandalimin e Abuzimit Seksual të Fëmijëve dhe në Veçanti e Abuzimit Seksual Brenda Rrethit të Tyre të Besimit në të Gjitha Nivelet.

- Ngritja e shërbimeve komunitare më qëllim ofrimin e shërbimeve parandaluese, ndërgjegjësuese dhe rritjen e sensibilizimit të shoqërisë dhe vetë fëmijëve, prindërve dhe profesionistëve në mënyrë që të ndërhyhet para se abuzimi të ndodhë dhe jo siç tregon praktika që ndërhyrja ndodh atëherë kur “dëmtimi” nga abuzimi ka ndodhur.
- Nëpërmjet fushatave kombëtare mund të rriten ndërhyrjet në komunitet për të modifikuar normat sociale që influencojnë abuzimin seksual të fëmijës: si rritja e sensibilitetit dhe empatisë për viktimat e abuzimit, rritja e ndërgjegjësimit për nivelin e dhunës në shoqëri dhe impaktin e saj dhe rritja e ndërgjegjësimit për ekzistencën e abuzimit seksual brenda rrethit të besimit dhe pasojat e saj tek mirëqenia e fëmijës dhe e gjithë shoqëria. Në organizimin e këtyre fushatave, media të konsiderohet një partner shumë i rëndësishëm.
- Programet e fokusuara në mirëfunksionimin e familjes dhe praktikatat prindërore kanë rezultuar të suksesshme në shumë vende lidhur me reduktimin e abuzimit seksual të fëmijëve. Këto programe synojnë të ndërgjegjësojnë prindërit dhe vetë fëmijët mbi rrezikun që ekziston brenda rrethit të tyre të besimit si dhe të aftësojnë fëmijët, prindërit e kujdestarët e tjerë mbi mënyrat e mbrojtjes në situata rreziku. Ofrimi i programeve edukuese mbi prindërimin dhe kurse për prindërimin pozitiv, duke targetuar kryesisht familjet më vulnerabël dhe me rrezik potencial më të lartë.
- Përmirësimi i kurrikulave shkollore. Aktualisht, kurrikulat ekzistuese nuk trajtojnë çështje të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit. Duke qenë se abuzimi seksual i fëmijëve ndodh kryesisht brenda rrethit të besimit, lind nevojë urgjente të ndërhyhet sa më shpejt në kurrikulat ekzistuese.
- Forcimi i mekanizmave të monitorimit për mbrojtjen e fëmijëve në institucionet rezidenciale përmes institucionalizimit të rolit të Monitoruesit të Pavarur të Jashtëm për fëmijët në institucionet e përkujdesit; ndërgjegjësimit dhe edukimit të fëmijëve në institucione mbi abuzimin seksual brenda rrethit të besimit dhe mënyrat e mbrojtjes, raportimit dhe denoncimit; si edhe hartimin dhe nënshkrimin e Politikave të Mbrojtjes së Fëmijës brenda institucioneve rezidenciale dhe atyre jo-rezidenciale për fëmijët, nga personeli, vullnetarët dhe çdo vizitor që është në kontakt me fëmijët.

Ngritja e Shërbimeve Mbështetëse të Specializuara për Fëmijët e Abuzuar Seksualisht, me Fokus Rehabilitimin dhe Ri-Integrimin e Fëmijëve.

- Ngritja e shërbimeve të specializuara për fëmijët e abuzuar seksualisht, në formën e qendrave “Barnahus”, si qendra multidisiplinare, shumë sektoriale dhe miqësore për fëmijët ku të gjithë profesionistët nga drejtësia, rendi, shërbimet sociale, shëndetësore

dhe ato psikologjike ofrohen nën të njëjtën çati, për të hetuar raste të dyshuara të abuzimit seksual të fëmijëve dhe ofruar mbështetje të përshtatshme për fëmijët viktime të abuzimit seksual. Koncepti bazë i modelit Barnahaus është shmangia e riviktimizimit të fëmijës si rezultat i intervistave të shumëfishta nga profesionistë të ndryshëm.

- Ofrimi i shërbimeve mbështetëse rehabilituese dhe ri-integruese afatgjata për fëmijët e abuzuar dhe për familjarët e tyre, sidomos shërbimet e shëndetit mendor dhe trajtimin afatgjatë psiko-social të fëmijës dhe familjarëve të tyre. Këto shërbime duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë fëmijët, të marrin parasysh nevojat e veçanta të tyre sidomos për fëmijët me aftësi të kufizuara ose diversitetin kulturor të fëmijëve dhe të ofrojnë mbrojtjen e nevojshme për fëmijët sa i përket privatësisë dhe sigurisë.
- Hartimi i manualeve dhe udhëzuesve të punës për t'u ardhur në ndihmë profesionistëve nga sektorë dhe agjenci të ndryshme, për mënyrat e ndërhyrjes në rastet e abuzimit seksual të fëmijëve. Këto manuale duhet të jenë praktike, të reflektojnë nevojat specifike të fëmijëve sipas llojit të abuzimit seksual, duke përfshirë edhe abuzimin seksual brenda rrethit të besimit dhe të ndihmojnë bashkëpunimin ndër-sektorial dhe zbatimin më të mirë të procedurave aktuale në vend për trajtimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht.
- Ngritja dhe trajnimi i një grupi burimor ekspertësh të specializuar për t'u ardhur në ndihmë të menjëhershme fëmijëve të abuzuar seksualisht, si dhe për të ofruar shërbim dhe trajtim afatgjatë për fëmijët viktime të abuzimit seksual dhe familjet e tyre. Grupi burimor i specializuar do të shërbejë si mbështetje edhe për profesionistët e tjerë të nivelit të parë në terren, në rastet e përballjes me situata emergjente dhe shumë të rënda të abuzimit seksual të fëmijëve.
- Për ngritjen e këtyre qendrave, duhet të parashikohen buxhete apo të rishpërndahen ato aktuale që shkojnë për qendrat e kujdesit rezidencial për fëmijët. Në këtë mënyrë, sistemi do të mund t'i përgjigjej nevojave për mbrojtje dhe trajtim të rasteve të fëmijëve të abuzuar. Kjo do të sillte dhe shmangien e vendosjes së rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht dhe qëndrimin e tyre për një kohë shumë të gjatë në institucionet e përkujdesit për fëmijët pa marrë trajtimin e nevojshëm të specializuar.

Forcimi i Shërbimeve dhe Kapaciteteve Njerëzore që Punojnë në Sistemin e Mbrojtjes së Fëmijëve.

Autoritetet lokale dhe qendrore, përgjegjëse për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri duhet të forcojnë shërbimet ekzistuese për një përgjigje adekuate dhe më të shpejtë ndaj rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit, sidomos sa i përket rritjes së identifikimit të hershëm dhe referimit.

- Rritja e numrit të NJMF-ve dhe mbulimi më i madh me burime njerëzore do të minimizonte keqmenaxhimin e rasteve të abuzimit seksual dhe do të lehtësonte zbatimin, monitorimin dhe ndjekjen e rasteve të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit.
- Përmirësimi ose ndërtimi i mjediseve të posaçme (miqësore) të trajtimit për fëmijët e abuzuar seksualisht, sidomos në polici dhe në shërbimin shëndetësor, do të përmirësonte ndjeshëm zbatimin e të drejtave të fëmijëve për shërbime miqësore dhe trajtim me dinjitet nga profesionistët, si edhe do të rriste shkallën e besimit të fëmijës tek sistemi.

- Rritja e numrit të psikologëve që ofrojnë shërbimin e tyre pranë shkollave do të mundësonte identifikimin e hershëm të fëmijëve në rrezik dhe do të lehtësonte trajtimin e tyre.
- Rritja e numrit të psikologëve që punojnë me kohë të plotë pranë organeve të rendit (policisë) do të minimizonte vonesat në vlerësimin e fëmijës së abuzuar, duke lehtësuar kështu trajtimin e mëtejshëm të rastit.
- Hartimi i programeve të trajnimit që synojnë ndërtimin e kompetencave, njohurive dhe aftësive që duhet të kenë profesionistët që punojnë me fëmijët nga të gjitha fushat e shërbimeve për marrjen e masave parandaluese dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht.
- Trajnime të vazhduara për të gjithë profesionistët që ofrojnë shërbime të specializuara (punonjës social, policë, prokurorë, gjykatës, mjekë, psikologë, mësues) mbi mënyrën se si të trajtojnë rastet e abuzimit seksual brenda rrethit të besimit konsiderohen shumë të rëndësishme për të përmirësuar jo vetëm performancën dhe gatishmërinë e tyre, por edhe për të forcuar bashkëpunimin midis institucioneve.

Përmirësimi i Kuadrit Ligjor

Edhe pse ka patur përmirësime në kuadrin ligjor lidhur me rritjen e dënimit për abuzuesit, përsëri vlerësohet se dënimet që jepen në rastet e abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit nuk janë të rënda.

- Nisur nga gjetjet e këtij studimi, lidhur me pengesat që hasin profesionistët për denoncimin e rasteve të dyshuara në polici, është e nevojshme të bëhen ndryshime ligjore lidhur me të drejtën që duhet të ketë policia për fillimin e investigimit në rastet e dyshuara, pa prituri që të bëhet një denoncim.
- Nisur nga fakti që ka mosraportim nga ana e profesionistëve të rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve, duhet përcaktuar me ligj raportimi i detyrueshëm, së bashku me mekanizmin monitorues dhe sanksionet në rastet e mos-raportimit. Gjithashtu vlerësohet e rëndësishme edhe rishikimi i detyrave të profesionistëve për të pasur detyrimin që të mbajnë në vëzhgim faktin që autorët e krimeve të tilla të mos mund të punojnë në ambiente me fëmijë pasi kanë shlyer dënimin.
- Lidhur me mbështetjen afatgjatë të viktimës dhe familjarëve të tij, duhet të mbështetet me ligj ofrimi i shërbimit psikologjik të specializuar dhe falas për fëmijët e abuzuar seksualisht dhe për familjarët e tyre. Nga ana tjetër, për të parandaluar përsëritjen e krimit, duhet të jetë i detyrueshëm trajtimi i detyruar psikologjik i autorëve të krimit.
- Përcaktimi më i saktë i krimit të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit, duke e përafëruar atë me përcaktimin e Konventës së Lanzarotës në Kodin Penal që të përfshijë të gjithë personat e mundshëm që mund të abuzojnë me pozitën e tyre të besimit, autoritetit ose të ndikimit.
- Të kryhet një analizë më e thelluar e kuadrit ligjor për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, e cila duhet të paraqesë mangësitë dhe nevojën për përmirësime ligjore, si dhe të përbëjë një bazë të vlefshme për hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore të reja, politikave dhe ndërhyrjeve për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, e në veçanti nga abuzimi seksual brenda rrethit të besimit.

Përmirësimi i Sistemit të Informacionit për Abuzimin Seksual Ndaj Fëmijëve.

- Për të përmirësuar procesin e monitorimit dhe të përgjegjshmërisë së strukturave të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, konsiderohet e rëndësishme ngritja e një sistemi kombëtar, të unifikuar dhe të standardizuar për mbledhjen e të dhënave për abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve, duke përfshirë edhe abuzimin seksual brenda rrethit të tyre të besimit, ku të gjitha institucionet të kenë detyrimin për mbledhjen dhe raportimin e tyre sipas treguesve të unifikuar dhe të standardizuar. Një gjë e tillë do të shmangte humbjen apo mbivendosjen e rasteve si dhe do të siguronte të dhëna periodike të disagreguara, të cilat do të ishin informative mbi shkallën e problemit të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të tyre të besimit duke ndihmuar në hartimin e programeve parandaluese të bazuara në evidencë dhe ndërmarrjen e ndërhyrjeve konkrete lidhur me fenomenin e abuzimit seksual të fëmijëve.
- Gjithashtu, një sistem i tillë mund të shërbente edhe si një mekanizëm monitorimi për të vlerësuar bashkëpunimin mes institucioneve dhe hapat e ndjekura për rastet e evidentuara dhe, në veçanti, si një monitorim i kohëzgjatjes së mbështetjes të rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht.

Forcimi i Rolit të Mediave për Raportimin e Përgjegjshëm të Rasteve të Abuzimit Seksual të Fëmijëve.

- Trajnimi i vazhdueshëm i gazetarëve mbi abuzimin seksual të fëmijëve, dhe në veçanti mbi atë brenda rrethit të besimit, për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit, njohurive dhe shprehive të punës që do të çonin në një trajtim më të përgjegjshëm dhe empatik të mediave për rastet e abuzimit seksual të fëmijëve.
- Organizimi i takimeve të përbashkëta të punës ndërmjet profesionistëve të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe përfaqësuesve të mediave për të trajtuar fenomenin aktual në Shqipëri dhe mënyrat e përgjigjeve nga sistemi i mbrojtjes së fëmijëve.
- Angazhimi më aktiv i organizatave të shoqërisë civile, strukturave të monitorimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në vend dhe institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve për denoncimin e mediave në rastet e raportimeve mbi abuzimin seksual të fëmijëve që dhunojnë të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut, si dhe shkelin parimet e punës dhe ligjet për mbrojtjen e fëmijëve në vend.
- Përfshirja aktive e mediave dhe partneriteti me mediat për organizimin e fushatave ndërgjegjëse dhe edukuese të publikut për të luftuar fenomenin e abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit në vend.

Shtojcat

Shtojca 1: Përbërja e Fokus-grupeve, Instrumentet e Përdorur Gjatë Fokus grupeve dhe Intervistave dhe Analiza e të Dhënave

Realizimi i Fokus-grupeve për të Përftuar (ndriçuar) Perspektivën Shoqërore të Fenomenit të Abuzimit Seksual ndaj Fëmijëve në Shqipëri

■ Fokus-grupet me profesionistët

Grupet e targetuara që morën pjesë në këto diskutime konsistuan në disa kampione konveniente profesionistësh që punojnë me fëmijët viktime të abuzimit seksual, si dhe profesionistë që punojnë me fëmijët në përgjithësi (në sektorët e edukimit/arsimit, shërbimet shëndetësore, sektori i drejtësisë, organet dhe institucionet e zbatimit të ligjit, si dhe shoqata jo fitimprurëse që operojnë në këtë drejtim).

Përfshirja e profesionistëve të grupeve të ndryshme në këtë studim synonte jo vetëm vlerësimin e rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve, por edhe vlerësimin e nevojave konkrete për asistencë dhe trajnim në të ardhmen.

Gjithashtu, diskutimet e fokus-grupeve kishin si qëllim ndriçimin e karakteristikave të fenomenit të abuzimit seksual ndaj fëmijëve, si dhe identifikimin e normave shoqërore që ndikojnë në këtë fenomen sipas këndvështrimit të profesionistëve përkatës.

Në tërësi, u zhvilluan tetë fokus-grupe me profesionistë të grupeve të ndryshëm, nga dy fokus-grupe në secilin rreth, përkatësisht në Tiranë, Shkodër, Korçë dhe Fier.

■ Fokus-grupet me fëmijët dhe me prindërit

Nga dy fokus-grupe me fëmijët dhe dy fokus-grupe me prindërit u realizuan gjithashtu në zonat urbane dhe në zonat rurale të tre rretheve të ndryshme përfshi Fierin, Tiranën dhe Korçën, duke mundësuar kështu një përfaqësim të këndvështrimeve dhe perspektivave të fëmijëve dhe prindërve nga zona të ndryshme gjeografike dhe segmente të ndryshme social-ekonomike të popullatës shqiptare.

■ Fokus-grupet me profesionistët për gazetarët, si dhe fokus-grupet me vetë gazetarët

Një studim pilot (në "miniaturë") u përfshi gjithashtu me qëllim që të vlerësoheshin perceptimet dhe këndvështrimet e profesionistëve mbi rolin e medias lidhur me fenomenin e abuzimit seksual ndaj fëmijëve, si dhe vetë-perceptimin e gazetarëve mbi mbulesën dhe menaxhimin mediatik të rasteve të dhunës seksuale ndaj fëmijëve.

Dy fokus-grupe u realizuan me profesionistë të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve (në Tiranë dhe në Elbasan) dhe dy fokus-grupe të tjera me gazetarë, kryesisht me përvojë në mbulimin mediatik të rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve (që të dy fokus-grupet me gazetarët u realizuan në Tiranë).

■ **Intervistat me prindërit jo-abuzues**

Gjithashtu, në këtë studim u realizuan edhe intervista me prindër jo-abuzues, me qëllim që të përftoheshin këndvështrimet dhe pikëpamjet e prindërve të tillë lidhur me fenomenin e abuzimit seksual ndaj fëmijëve, si dhe karakteristikat dhe normat shoqërore përkatëse të lidhura me këtë fenomen.

■ **Intervistat me fëmijët viktime të abuzimit seksual**

Një tjetër komponent i studimit konsistoi edhe në intervistimin e disa fëmijëve viktime të abuzimit seksual me qëllim që të gjenerohej informacion i vlefshëm mbi perspektivën, opinionet, pikëpamjet dhe ndjesitë e këtij kontingjenti të viktimizuar të fëmijëve në vendin tonë.

■ **Rastet ekzemplare të studimit**

Në këtë studim u përdorën edhe disa raste ekzemplare të abuzimit seksual ndaj fëmijëve në mënyrë që të identifikoheshin më mirë edhe aspektet e menaxhimit përkatës të këtyre rasteve. Këto raste u shqyrtuan dhe u analizuan pas autorizimit nga institucionet dhe organizatat përkatëse në Shqipëri.

Gjithsej u përfshinë 30 raste të tilla të raportuara përgjatë vitit 2014 dhe 2015. Në këtë pikë, Tdh ofroi material shumë të vlefshëm në sajë të aktiviteteve të saj mbështetëse për shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve të dhunuar.

Për secilin rast individual, u aplikua një protokoll (instrument) bazë për ekstraktimin (përfitim) e informacionit specifik të nevojshëm.

Në të gjitha rastet, të dhënat e përfuara ofruan rezultate *indikativë* dhe *jo përfaqësuese* në shkallë kombëtare për vetë karakterin konvenient të përfshirjes në studim të këtyre rasteve ekzemplare.

Gjithashtu, u përfshinë në rezultatet e studimit edhe disa aspekte kualitative (cilësore) bazuar në shembuj konkretë, apo citime të drejtpërdrejta bazuar në rastet ekzemplare në dispozicion.

■ **Instrumentet e studimit**

Një protokoll i detajuar për përmbajtjen dhe strukturën e diskutimeve në fokus-grupe u përgatit paraprakisht dhe më pas ekipi i profesionistëve për mbledhjen e të dhënave u trajnuar për moderimin dhe lehtësimin e takimeve përkatëse.

Gjithashtu, profesionistët e mbledhjes së të dhënave në këtë studim u trajnuan edhe për menaxhimin e kohës sipas kategorive përkatëse të individëve të përfshirë në fokus-grupe të ndryshme. Në ato raste ku nuk ishte e mundur që të organizohej një fokus-grup i caktuar, u përdor një alternativë tjetër (në një zonë tjetër të përfshirë në studim), përfshirë këtu edhe disa intervista të veçanta me persona kyç sipas kategorive përkatëse.

Në rubrikën në vijim paraqiten në mënyrë të detajuar të gjitha instrumentet e studimit sipas kontingjentit (kampionit) të përfshirë në fokus-grupe dhe në intervista.

Formulari i të Dhënave Statistike për Agjencitë dhe Organizatat Përgjegjëse për Menaxhimin dhe Trajtimin e Rasteve të Abuzimit Seksual të Fëmijëve.

Përshkrimi

Emri i institucionit/Organizatës/Shoqatës

Spektori në të cilin ushtron aktivitetin

Lidhja me institucione/agjenci të tjera (nëse ka)

Statusi ligjor

Rajoni (qyteti/zona)

Numri i personelit me kohë të plotë (1-5, 5-50, mbi 50)

Numri i personelit të kualifikuar (me diplomë universitare): 1-5, 5-50, mbi 50

Lloji i praktikës standarde të ndjekur për regjistrimin e të dhënave (regjistrim në letër, regjistrim elektronik, listë e thjeshtë e përfituesve të shërbimeve, lloje të tjera regjistrimi, asnjë lloj regjistrimi)

Të dhëna statistikore të mbledhura	Numri i rasteve të ASF
Numri i përgjithshëm i rasteve të fëmijëve të abuzuar ose neglizhuar	
Numri i rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht	
Gjinia e fëmijëve viktime të abuzimit (Femër/Mashkull)	
Numri i rasteve të ASF të ndodhur brenda rrethit të besimit ²	
Raporti femra-meshkuj i rasteve të ASF të ndodhur brenda rrethit të besimit	
Numri i rasteve të ASF në të cilën janë të pranishme edhe lloje të tjera të abuzimit	
Numri i rasteve në të cilat ka ndodhur vërtetimi i akuzave (të vërtetuar/të pavërtetuar/në pritje, ose e paqartë)	
Numri i rasteve të ASF sipas grup-moshës së fëmijëve të abuzuar (0-5, 6-12, 13-18)	
Për sa më sipër, në sa raste fëmijët e abuzuar janë femra	
Për sa më sipër, sa raste kanë ndodhur brenda rrethit të besimit	
Numri i rasteve në të cilat kanë ndodhur lëndime të përkohshme	
Numri i rasteve në të cilat kanë ndodhur lëndime të përhershme	
Numri i rasteve me pasojë vdekjen	
Numri i rasteve në të cilat fëmijët e abuzuar kanë vuajtur nga sëmundje të rënda kronike dhe/ose kanë qenë me aftësi të kufizuara para incidentit	

2 Abuzimi seksual i fëmijëve në "rrethin e besimit" i referohet dhunimit seksual të fëmijëve nga një ose disa persona të njohur dhe të besuar të cilët kanë autoritet dhe influencë tek fëmijët, përfshi këtu edhe personat brenda familjes së ngushtë.

Numri i rasteve në të cilat fëmija i abuzuar ose familjarët kanë qenë të njohur më parë nga shërbimet për arsye të tjera.	
Numri i rasteve në të cilat fëmija i abuzuar ka qenë më parë i njohur për sjellje kriminale.	
Numri i rasteve me viktime të shumëfishta (më shumë se një fëmijë i abuzuar)	
Numri i rasteve me dhunues të shumëfishtë	
Numri i rasteve në të cilat autor i abuzimit ka qenë babai	
Numri i rasteve në të cilat autore e abuzimit ka qenë nëna	
Numri i rasteve në të cilat ka patur të paktën një prind biologjik jo-abuzues	
Numri i rasteve ku autori i abuzimit ka qenë minoren	
Numri i rasteve në të cilat janë përfshirë agjencitë e zbatimit të ligjit ose ato juridike	
Për sa më sipër, në sa raste janë marrë masa të ashpra kundër autorit/ëve të abuzimit?	
Për sa më sipër, në sa raste ka patur dënime kundër autorit/ëve të abuzimit?	
Mesatarisht, sa ka qenë dënimi për autorët e abuzimit ndaj fëmijëve?	
Numri i rasteve në të cilat është siguruar kujdes shëndetësor për fëmijën e abuzuar dhe/ose për anëtarët jo abuzues të familjes së tij	
Numri i rasteve në të cilat janë siguruar shërbime mbështetëse/konsultuese për fëmijën e abuzuar dhe/ose për anëtarët jo abuzues të familjes së tij	
Numri i rasteve në të cilat fëmija viktimë është larguar nga familja biologjike	
Numri i rasteve në të cilat fëmija i abuzuar është vendosur në institucione rezidenciale (qendra me më shumë se 10 përfitues rezidencial)	

Protokolli i Fokus Grupeve me Profesionistët që Merren me Mbrojtjen e Fëmijëve të Dhunuar

Dhuna ndaj fëmijëve përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik, psiko-emocional, abuzimin seksual, neglizhencën, apo shfrytëzimin e fëmijëve – duke shkaktuar në këtë mënyrë dëmtime të gjendjes shëndetësore të fëmijëve, pengesa në zhvillim, si dhe humbjen e dinjitetit.

Në veçanti, **abuzimi seksual** i fëmijëve nënkupton përfshirjen e fëmijëve në aktivitete seksuale të cilat ato nuk i kuptojnë plotësisht, ose nuk janë të përgatitur apo të zhvilluar (të rritur) prandaj edhe janë të paaftë që të japin miratimin/pëlqimin përkatës, ose aktivitete të cilat bien ndesh me ligjet dhe tabútë e shoqërisë.

Dhuna seksuale ndaj fëmijëve evidentohet nga aktivitete të tilla mes fëmijës dhe një personi të rritur, ose një tjetër fëmijë më të rritur i cili ka marrëdhënie besimi, apo pushteti (autoriteti) me fëmijën e dhunuar.

Aktivitete të tilla të lidhura me abuzimin seksual të fëmijëve mund të përfshijnë situatat e mëposhtme (listë e cila nuk është aspak shteruese):

- Përfshirja e fëmijëve në aktivitete seksuale të paligjshme;
- Shfrytëzimi i fëmijëve për prostitucion, ose praktika të tjera të paligjshme;
- Shfrytëzimi i fëmijëve për performanca të ndryshme pornografike.

Abuzimi seksual i fëmijëve në “rrethin e besimit” i referohet dhunimit seksual të fëmijëve nga një ose disa persona të njohur dhe të besuar të cilët kanë autoritet dhe influencë tek fëmijët, përfshi këtu edhe personat brenda familjes së ngushtë.



TEMA 1: Kuadri i përgjithshëm i studimit (10 min.)

Ndërkohë që përgatiten, moderatori duhet t'i drejtojë pjesëmarrësve pyetjet e mëposhtme:

1. Sipas përvojës suaj personale, a janë shërbimet e mjaftueshme dhe efektive (të përshtatshme) për adresimin e ASF brenda rrethit të besimit të fëmijëve të abuzuar?
2. Bazuar në përvojën tuaj, cilat janë kufizimet apo dobësitë (dështimet) kryesore në funksionimin e përgjithshëm të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve?



TEMA 2: Funksionimi dhe përshtatshmëria e shërbimeve ekzistuese (60 min.)

1. Në përgjithësi, si do ta vlerësonit efikasitetin e kuadrit ligjor në Shqipëri për adresimin e ASF të ndodhur brenda rrethit të besimit të fëmijës së abuzuar?
2. Bazuar në përvojën tuaj personale, (afërsisht) në sa përqind të rasteve ka ndodhur që të përfshihen eventalisht shërbimet juridike?
3. Bazuar në përvojën tuaj personale, (afërsisht) në sa përqind të rasteve ka ndodhur që të përfshihen eventalisht shërbimet shëndetësore?
4. Në përgjithësi, si do ta vlerësonit sasinë dhe efektivitetin e shërbimeve shëndetësore në Shqipëri për të adresuar ASF të ndodhur brenda rrethit të besimit të fëmijës së abuzuar?
5. Bazuar në përvojën tuaj personale, (afërsisht) në sa përqind të rasteve ka ndodhur që të përfshihen eventalisht shërbimet sociale?
6. Në përgjithësi, si do ta vlerësonit sasinë dhe efektivitetin e shërbimeve shëndetësore që operojnë aktualisht në Shqipëri për të adresuar ASF të ndodhur brenda rrethit të besimit të fëmijës-viktimë?
7. Bazuar në përvojën tuaj personale, (afërsisht) në sa përqind të rasteve ka ndodhur që të përfshihen eventalisht shërbimet administrative?
8. Në përgjithësi, si do ta vlerësonit sasinë dhe efektivitetin e kuadrit administrativ që vepron në Shqipëri (përfshijë atë ligjor; p.sh. bashkëpunimi dhe referimi mes shërbimeve kur është e nevojshme, etj.) për të adresuar ASF të ndodhur brenda rrethit të besimit të fëmijës së abuzuar?
9. Bazuar në përvojën tuaj personale, a e garantojnë profesionistët konfidencialitetin e rasteve ASF?
10. Në përgjithësi, si do t'i vlerësonit njohuritë, sjelljet dhe kompetencat e personelit arsimor në Shqipëri, për të njohur, marrë dhe menaxhuar akuzat për ASF të ndodhur brenda rrethit të besimit të fëmijës së abuzuar?
11. Cilin sektor apo shërbim tjetër e konsideroni si më shumë relevant (të rëndësishëm) për gjendjen aktuale të kësaj çështjeje në vendin tonë?



TEMA 3: Nëntema specifike për adresimin e ASF në rrethin e besimit (njohuri të përgjithshme mbi çështjen) (40 min)

Qartësi & saktësia

Udhëzime për moderatorin: Ju lutemi pyesni pjesëmarrësit nëse ndonjëra nga temat (çështjet) e mëposhtme ka nevojë për sqarime. Nëse po, ju lutemi jepini përkufizimet përkatëse si dhe ndonjë informacion të vlefshëm para diskutimit të secilës temë (çështje).

Diskutimi i secilës çështje

Për secilën temë (çështje), moderatori duhet t'u drejtojë pjesëmarrësve pyetjet e mëposhtme:

1. Sipas mendimit tuaj, a është zbatuar në mënyrë të mjaftueshme dhe efektive mbledhja e rregullt e të dhënave administrative për rastet e ASF?
2. Sipas mendimit tuaj, a duhet të përfshihet apo jo kufizimi kohor në legjislacionin kombëtar lidhur me rastet e ASF?
3. A jeni në dijeni për ligjin mbi raportimin e detyrueshëm të rasteve me ASF?
4. A mendoni se, përgjithësisht, ky ligj zbatohet? D.m.th., rastet e fëmijëve të dhunuar seksualisht në rrethin e besimit raportohen nga profesionistët?
5. Sipas mendimit tuaj, cila është përqindja e akuzave të rreme të bëra nga fëmijët dhe adoleshentët ndaj personave brenda rrethit të besimit për rastet e ASF?
6. Sipas mendimit tuaj, cila është përqindja e rasteve të ASF brenda rrethit të besimit që janë raportuar në procese divorci?
7. Sa përqind të rasteve të ASF i konsideroni që ndodhin brenda rrethit të besimit të fëmijës së abuzuar?
8. Sipas mendimit tuaj, a mund të jenë akuzat për ASF brenda rrethit të besimit produkt i sugjerimeve apo influencës së personave të tjerë që janë pranë fëmijës?
9. Sipas mendimit tuaj, a i harrojnë eksperiencat traumatike viktimat aktuale të ASF? A mund që t'i kujtojnë këto eksperiencat pas një periudhe harrese?
10. Sipas mendimit tuaj, a ka mjaftueshëm burime efektive në Shqipëri për sigurimin e shërbimeve (kujdesin) dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë të ASF të ndodhur brenda rrethit të besimit dhe prindërve të tyre jo-abuzues?



TEMA 4: Mbyllja (10 min.)

1. Në përgjithësi, cili është opinionimi juaj mbi gjendjen aktuale të sistemit tonë lidhur me mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual?
2. Cilat do ishin sugjerimet ose rekomandimet tuaja kryesore për përmirësimin e situatës?

Protokolli i Fokus Grupeve me Mediat.

Dhuna ndaj fëmijëve përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik, psiko-emocional, abuzimin seksual, neglizhencën, apo shfrytëzimin e fëmijëve – duke shkaktuar në këtë mënyrë dëmtime të gjendjes shëndetësore të fëmijëve, pengesa në zhvillim, si dhe humbjen e dinjitetit.

Në veçanti, abuzimi seksual i fëmijëve nënkupton përfshirjen e fëmijëve në aktivitete seksuale të cilat ato nuk i kuptojnë plotësisht, ose nuk janë të përgatitur apo të zhvilluar (të rritur) prandaj

edhe janë të paaftë që të japin miratimin/pëlqimin përkatës, ose aktivitete të cilat bien ndesh me ligjet dhe tabûtë e shoqërisë.

Dhuna seksuale ndaj fëmijëve evidentohet nga aktivitete të tilla mes fëmijës dhe një personi të rritur, ose një tjetër fëmijë më të rritur i cili ka marrëdhënie besimi apo pushteti (autoriteti) me fëmijën e dhunuar.

Aktivitete të tilla të lidhura me abuzimin seksual të fëmijëve mund të përfshijnë situatat e mëposhtme (listë e cila nuk është aspak shteruese):

- Përfshirja e fëmijëve në aktivitete seksuale të paligjshme;
- Shfrytëzimi i fëmijëve për prostitucion, ose praktika të tjera të paligjshme;
- Shfrytëzimi i fëmijëve për performanca të ndryshme pornografike.

Abuzimi seksual i fëmijëve në “rrethin e besimit” i referohet dhunimit seksual të fëmijëve nga një ose disa persona të njohur dhe të besuar të cilët kanë autoritet dhe influencë tek fëmijët, përfshi këtu edhe personat brenda familjes së ngushtë.



TEMA 1: Kuadri i përgjithshëm i studimit (10 min.)

Ndërkohë që përgatiten, moderatori duhet t’i drejtojë pjesëmarrësve pyetjet e mëposhtme:

1. Bazuar në përvojën tuaj personale, a është i mjaftueshëm dhe efektiv mbulimi nga media i rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit?
2. Cilat janë problemet kryesore në perceptimin publik lidhur me ASF brenda rrethit të besimit, bazuar në përvojën tuaj të deritanishme?
3. Cilat janë problemet kryesore në portretizimin në media të ASF brenda rrethit të besimit, bazuar në përvojën tuaj të deritanishme?



TEMA 2: Funkionimi dhe përshtatshmëria e shërbimeve ekzistuese (60 min.)

1. Sipas përvojës suaj personale, si i vlerësoni shërbimet shëndetësore për adresimin e ASF brenda rrethit të besimit të fëmijëve të abuzuar?
2. A mendoni se shërbimet shëndetësore janë të mjaftueshme dhe efektive (të përshtatshme)?
3. Bazuar në përvojën tuaj personale, cilët prej sektorëve të mëposhtëm përfaqësohen rregullisht në media si të përfshirë në menaxhimin dhe trajtimin e rasteve të ASF brenda rrethit të besimit: drejtësia, policia, shërbimet sociale, shëndetësia, arsimi; dhe sipas cilës renditje?
4. Bazuar në përvojën tuaj personale, a interesohet zakonisht media për çështjet/problemet strukturore dhe funksionale (p.sh. si funksionojnë procedurat ekzistuese/sistemi i mbrojtjes së fëmijëve) në mbulimin e rasteve të ASF brenda rrethit të besimit, apo kryesisht fokusohet vetëm në disa raste individuale të spikatura (të bujshme)?
5. Bazuar në përvojën tuaj personale, a është mbulimi nga media i rasteve të ASF brenda rrethit të besimit në përputhje me atë që dëshiron të informohet publiku mbi këto raste të cilat theksohen në media?

6. A mendoni se media që mbulon rastet e ASF respekton rregullisht të drejtat themelore të palëve të përfshira (fëmija e abuzuar, familja e tij, dhunuesi i dyshuar)?
7. A mendoni se media që mbulon rastet e ASF e paracakton dhe e paragjykon dhunuesin/it, duke dhunuar kështu të drejtat themelore të të paditurit (dhunuesit të supozuar)?
8. A mund të kujtoni ndonjë rast ASF ku mbulimi paraprak nga media ka qenë plotësisht i pasaktë (për shembull, duke portretizuar një të pafajshëm si dhunues, etj.)? A mund t'i numëroni të gjitha rastet që ju kujtohen?
9. Bazuar në përvojën tuaj personale, a është selektive (e anshme) media në një mbështetje të heshtur të dallimeve i rritur-fëmijë dhe mashkull-femër? Nëse po, cilën anë mban zakonisht?
10. Bazuar në përvojën tuaj personale, a e garanton media konfidencialitetin e rasteve ASF?
11. Bazuar në përvojën tuaj personale, a mendoni se publiku dhe media do të ishin të gatshëm të pranonin zbatimin e një kodi etik për prezantimin e rasteve ASF?



TEMA 3: Nëntema specifike për adresimin e ASF në rrethin e besimit (njohuri të përgjithshme mbi çështjen) (40 min.)

Qartësi & saktësia

Udhëzime për moderatorin: Ju lutemi pyesni pjesëmarrësit nëse ndonjëra nga temat (çështjet) e mëposhtme ka nevojë për sqarime. Nëse po, ju lutemi jepini përkufizimet përkatëse si dhe ndonjë informacion të vlefshëm para diskutimit të secilës temë (çështje).

Diskutimi i secilës çështje

Për secilën temë (çështje) moderatorin duhet t'i drejtojë pjesëmarrësve pyetjet e mëposhtme:

1. Sipas mendimit tuaj, cili do të ishte përshkrimi më i saktë i perceptimit publik dhe mbulimit të medias lidhur me sistemin e mbrojtjes së fëmijëve: “marrja e fëmijës nga dikush që nuk është në gjendje ta rrisë”, apo “mbështetja e dikujt që përballet me vështirësi në rritjen e fëmijës, në mënyrë që të mund t’ia dalë mbanë”?
2. Sipas mendimit tuaj, a duhet që të përfshihet në legjislacionin tonë kufizimi kohor në rastet e ASF?
3. A jeni në dijeni për ligjin mbi raportimin e detyrueshëm të rasteve me ASF?
4. A mendoni se, përgjithësisht, ky ligj zbatohet? D.m.th., rastet e fëmijëve të dhunuar seksualisht në rrethin e besimit raportohen nga profesionistët e mediave?
5. Sipas mendimit tuaj, cila është përqindja e raportimeve false (të rreme) të bëra nga fëmijët dhe adoleshentët ndaj personave brenda rrethit të tyre të besimit në rastet e ASF?
6. Sipas mendimit tuaj, cila është përqindja e rasteve të ASF brenda rrethit të besimit që raportohen në rastet e divorceve konfliktuale?
7. Sa përqind të rasteve të ASF mendoni se ndodhin brenda rrethit të besimit të fëmijës së abuzuar?
8. Sipas mendimit tuaj, a mundet që raportimet për ASF brenda rrethit të besimit të jenë rezultat i sugjerimeve apo ndikimit të një të afërmi tjetër, i rritur apo fëmijë?
9. Sipas mendimit tuaj, a i harrojnë viktimat e ASF përvojat e tyre traumatike? A mund ta kujtojnë ato përvojën e tyre edhe pas një periudhe harrese?

10. Sipas mendimit tuaj, a ka burime të mjaftueshme dhe efektive në Shqipëri për të ofruar shërbime dhe mbrojtje për fëmijët viktime të ASF në rrethin e tyre të besimit, dhe për prindërit e tyre jo-abuzues?

TEMA 4: Mbyllja (10 min.)

1. Në përgjithësi, cili është mendimi juaj mbi situatën e tanishme të mbulimit nga media të rasteve të ASF?
2. Cilat janë sugjerimet apo rekomandimet tuaja kryesore për të përmirësuar portretizimin e tanishëm nga media të këtij fenomeni?
3. Cilat janë sugjerimet apo rekomandimet tuaja kryesore për të ndryshuar perceptimin publik mbi fenomenin?

Protokolli i Fokus Grupeve me Prindërit Jo-Abuzues të Fëmijëve të Dhunuar

Dhuna ndaj fëmijëve përfshin të gjitha format e keq-trajtimin fizik, psiko-emocional, abuzimin seksual, neglizhencën, apo shfrytëzimin e fëmijëve – duke shkaktuar në këtë mënyrë dëmtime të gjendjes shëndetësore të fëmijëve, pengesa në zhvillim, si dhe humbjen e dinjitetit.

Në veçanti, **abuzimi seksual** i fëmijëve nënkupton përfshirjen e fëmijëve në aktivitete seksuale të cilat ato nuk i kuptojnë plotësisht, ose nuk janë të përgatitur apo të zhvilluar (të rritur) prandaj edhe janë të paaftë që të japin miratimin/pëlqimin përkatës, ose aktivitete të cilat bien ndesh me ligjet dhe tabûtë e shoqërisë.

Dhuna seksuale ndaj fëmijëve evidentohet nga aktivitete të tilla mes fëmijës dhe një personi të rritur, ose një tjetër fëmijë më të rritur i cili ka marrëdhënie besimi, apo pushteti (autoriteti) me fëmijën e dhunuar.

Aktivitete të tilla të lidhura me abuzimin seksual të fëmijëve mund të përfshijnë situatat e mëposhtme (listë e cila nuk është aspak shteruese):

- Përfshirja e fëmijëve në aktivitete seksuale të paligjshme;
- Shfrytëzimi i fëmijëve për prostitucion, ose praktika të tjera të paligjshme;
- Shfrytëzimi i fëmijëve për performanca të ndryshme pornografike.

Abuzimi seksual i fëmijëve në "rrethin e besimit" i referohet dhunimit seksual të fëmijëve nga një ose disa persona të njohur dhe të besuar të cilët kanë autoritet dhe influencë tek fëmijët, përfshi këtu edhe personat brenda familjes së ngushtë.



TEMA 1: Kuadri i përgjithshëm i studimit (10 min.)

Ndërkohë që përgatiten, moderatori duhet t'i drejtojë prindërve pyetjet e mëposhtme:

1. Sipas përvojës suaj personale, a janë shërbimet e mjaftueshme dhe efektive (të përshtatshme) për adresimin e ASF brenda rrethit të besimit të fëmijëve të abuzuar?

2. Bazuar në përvojën tuaj, cilat janë kufizimet apo dobësitë (dështimet) kryesore në funksionimin e përgjithshëm të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve?



TEMA 2: Funksionimi dhe përshtatshmëria e shërbimeve ekzistuese (60 min.)

1. Sipas përvojës suaj personale, si i vlerësoni shërbimet shëndetësore për adresimin e ASF brenda rrethit të besimit të fëmijëve të abuzuar?
2. A mendoni se shërbimet shëndetësore janë të mjaftueshme dhe efektive (të përshtatshme)?
3. Sipas përvojës suaj personale, si i vlerësoni shërbimet sociale për adresimin e ASF brenda rrethit të besimit të fëmijëve të abuzuar?
4. A mendoni se shërbimet sociale janë të mjaftueshme dhe efektive (të përshtatshme)?
5. Sipas përvojës suaj personale, si do ta vlerësonit nivelin e ndërgjegjësimit, pikëpamjet dhe aftësitë e personelit arsimor në Shqipëri për identifikimin, pranimin dhe menaxhimin e raportimeve për ASF brenda rrethit të besimit të fëmijëve të abuzuar?
6. Cilin sektor apo shërbim e konsideroni si më të përshtatshmin në situatën e tanishme të shërbimeve?
7. Kur për herë të parë morët vesh mbi situatën në të cilën ishte përfshirë fëmija juaj, a e dinit se tek cila agjenci apo tek cili shërbim duhet të drejtoheshit?
8. Tek cila agjenci/shërbim u drejtuat fillimisht?
9. Gjatë trajtimit të rastit në të cilin ishte i përfshirë fëmija juaj, a ishte e vështirë për ju të përballeshit dhe me procedurat e nevojshme? Cilat ishin vështirësitë?
10. A e ruajtë konfidencialitetin kjo agjenci/institucion të cilit ju drejtuat fillimisht?
11. Sipas përvojës suaj personale, cili shërbim apo sektor ishte për ju më ndihmuesi (bashkëpunuesi) gjatë procedurave të rastit në të cilin ishte përfshirë fëmija juaj?
12. Sipas përvojës suaj personale, cili shërbim apo sektor ishte për ju më pak ndihmuesi gjatë procedurave të rastit në të cilin ishte përfshirë fëmija juaj?



TEMA 3: Nëntema specifike për adresimin e ASF në rrethin e besimit (njohuri të përgjithshme mbi çështjen) (40 min.)

Qartësi & saktësia:

Udhëzime për moderatorin: Ju lutemi pyetini pjesëmarrësit (prindërit) nëse ndonjëra nga temat (çështjet) e mëposhtme ka nevojë për sqarime. Nëse po, ju lutemi jepini përkufizimet përkatëse si dhe ndonjë informacion të vlefshëm para diskutimit të secilës temë (çështje).

Diskutimi i secilës çështje

Për secilën temë (çështje), moderatorin duhet t'i drejtojë prindërve pyetjet e mëposhtme:

1. Cilat shërbime, organizata apo agjenci do t'i konsideroni si më të përshtatshme dhe efektive për të ofruar ndihmë për fëmijët viktime të ASF brenda rrethit të besimit dhe prindërit e tyre jo-abuzues?
2. Sipas mendimit tuaj, a duhet të përfshihen në legjislacionin tonë kufizimet kohore për denoncimin e rasteve ASF?
3. Sipas mendimit tuaj, cila është përqindja e raportimeve false (të rreme) të bëra nga fëmijët dhe adoleshentët ndaj personave brenda rrethit të tyre të besimit në rastet e ASF?
4. Sipas mendimit tuaj, cila është përqindja e rasteve të ASF brenda rrethit të besimit që raportohen në rastet e divorceve konfliktuale?

5. Sa përqind të rasteve të ASF mendoni se ndodhin brenda rrethit të besimit të fëmijës së abuzuar?
6. Sipas mendimit tuaj, a mundet që raportimet për ASF brenda rrethit të besimit të jenë rezultat i sugjerimeve apo ndikimit të një të afërmi tjetër, i rritur apo fëmijë? Nga kush mendoni se bëhen më shpesh këto raportime?
7. Sipas mendimit tuaj, a i harrojnë viktimat e ASF përvojat e tyre traumatike? A mund ta kujtojnë ato përvojën e tyre edhe pas një periudhe harrrese?
8. Sipas mendimit tuaj, a ka burime të mjaftueshme dhe efektive në Shqipëri për të ofruar shërbime dhe mbrojtje për fëmijët viktimë të ASF në rrethin e tyre të besimit dhe për prindërit e tyre jo-abuzues?



TEMA 4: Mbyllja (10 min.)

1. Në përgjithësi, cili është opinioni dhe përvoja juaj personale mbi gjendjen e tanishme të sistemit lidhur me mbrojtjen e fëmijëve të abuzuar seksualisht?
2. Cilat janë sugjerimet apo rekomandimet tuaja kryesore për përmirësimin e situatës?

Protokolli i Fokus Grupeve me Prindërit Vulnerabël

Dhuna ndaj fëmijëve përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik, psiko-emocional, abuzimin seksual, neglizhencën, apo shfrytëzimin e fëmijëve – duke shkaktuar në këtë mënyrë dëmtime të gjendjes shëndetësore të fëmijëve, pengesa në zhvillim, si dhe humbjen e dinjitetit.

Në veçanti, **abuzimi seksual** i fëmijëve nënkupton përfshirjen e fëmijëve në aktivitete seksuale të cilat ato nuk i kuptojnë plotësisht, ose nuk janë të përgatitur apo të zhvilluar (të rritur) prandaj edhe janë të paaftë që të japin miratimin/pëlqimin përkatës, ose aktivitete të cilat bien ndesh me ligjet dhe tabûtë e shoqërisë.

Dhuna seksuale ndaj fëmijëve evidentohet nga aktivitete të tilla mes fëmijës dhe një personi të rritur, ose një tjetër fëmijë më të rritur i cili ka marrëdhënie besimi, apo pushteti (autoriteti) me fëmijën e dhunuar.

Aktivitete të tilla të lidhura me abuzimin seksual të fëmijëve mund të përfshijnë situatat e mëposhtme (listë e cila nuk është aspak shteruese):

- Përfshirja e fëmijëve në aktivitete seksuale të paligjshme;
- Shfrytëzimi i fëmijëve për prostitucion, ose praktika të tjera të paligjshme;
- Shfrytëzimi i fëmijëve për performanca të ndryshme pornografike.

Abuzimi seksual i fëmijëve në "rrethin e besimit" i referohet dhunimit seksual të fëmijëve nga një ose disa persona të njohur dhe të besuar të cilët kanë autoritet dhe influencë tek fëmijët, përfshi këtu edhe personat brenda familjes së ngushtë.



TEMA 1: Kuadri i përgjithshëm i studimit (10 min.)

Ndërsa pjesëmarrësit (prindërit) përgatiten për diskutim, moderatori bën pyetjet e mëposhtme:

1. Cili është opinioni juaj (bazuar kjo edhe në përvoja konkrete të kolegëve, miqve, apo familjarëve tuaj) për sistemin administrativ dhe kuadrin ligjor për adresimin e ASF brenda rrethit të besimit të fëmijëve të abuzuar?
2. Sipas mendimit tuaj, a janë sistemi administrativ dhe kuadri ligjor të mjaftueshëm dhe efektive (të përshtatshme) për adresimin e ASF brenda rrethit të besimit të fëmijëve të abuzuar?
3. Cilat janë kufizimet apo dështimet kryesore në funksionimin e përgjithshëm të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, sipas mendimit tuaj (bazuar kjo edhe në përvoja konkrete të kolegëve, miqve, apo familjarëve tuaj)?



TEMA 2: Funksionimi i procedurave ekzistuese dhe përshtatshmëria e shërbimeve ekzistuese (60 min.)

1. Sipas mendimit tuaj (bazuar kjo edhe në përvoja konkrete të kolegëve, miqve, apo familjarëve tuaj), si do ta vlerësonit kuadrin ligjor për mbrojtjen e fëmijëve të abuzuar në vendin tonë?
2. Sipas mendimit tuaj, a është i mjaftueshëm dhe efektiv (i përshtatshëm) kuadri ligjor për mbrojtjen e fëmijëve të abuzuar në vendin tonë?
3. Sipas mendimit tuaj (bazuar kjo edhe në përvoja konkrete të kolegëve, miqve, apo familjarëve tuaj), si do t'i vlerësonit shërbimet shëndetësore kundrejt fëmijëve të abuzuar në vendin tonë?
4. Sipas mendimit tuaj, a janë të mjaftueshme dhe efektive (të përshtatshme) këto shërbime shëndetësore për fëmijët e abuzuar në vendin tonë?
5. Sipas mendimit tuaj (bazuar kjo edhe në përvoja konkrete të kolegëve, miqve, apo familjarëve tuaj), si do t'i vlerësonit shërbimet sociale ndaj fëmijëve të abuzuar në vendin tonë?
6. Sipas mendimit tuaj, a janë të mjaftueshme dhe efektive (të përshtatshme) këto shërbime sociale për fëmijët e abuzuar në vendin tonë?
7. Sipas mendimit tuaj, si do ta vlerësonit nivelin e ndërgjegjësimit, pikëpamjet dhe aftësitë e personelit arsimor në Shqipëri për identifikimin, pranimin dhe menaxhimin e raportimeve të fëmijëve të abuzuar brenda rrethit të tyre të besimit?
8. Cilin sektor apo shërbim e konsideroni si më të përshtatshmin në situatën e tanishme të shërbimeve?
9. A jeni në dijeni se tek cila agjenci apo tek cili shërbim duhet të drejtohen prindërit vulnerabël?
10. Tek cila agjenci/shërbim mendoni se duhet të drejtoheni fillimisht në rast nevoje?
11. Sipas mendimit tuaj (bazuar kjo edhe në përvoja konkrete të kolegëve, miqve, apo familjarëve tuaj), cilat mund të jenë vështirësitë gjatë përballjes me këto shërbime?
12. A mendoni se këto shërbime janë në gjendje që të garantojnë konfidencialitetin e rasteve me ASF?
13. Sipas mendimit tuaj, cili shërbim apo sektor mund të jetë më i volitshmi në rast nevoje?
14. Sipas mendimit tuaj, cili shërbim apo sektor mund të jetë më pak bashkëpunuesi në rast nevoje?



TEMA 3: Nëntema specifike për adresimin e ASF në rrethin e besimit (njohuri të përgjithshme mbi çështjen) (40 min.)

Qartësia & saktësia

Udhëzime për moderatorin: Ju lutemi pyetini pjesëmarrësit (prindërit) nëse ndonjëra nga temat (çështjet) e mëposhtme ka nevojë për sqarime. Nëse po, ju lutemi jepini përkufizimet përkatëse si dhe ndonjë informacion të vlefshëm para diskutimit të secilës temë (çështje).

Diskutimet e secilës temë (çështje)

Për secilën temë (çështje), moderatori duhet t'i drejtojë prindërve pyetjet e mëposhtme:

1. Cilat shërbime, organizata apo agjenci do t'i konsideroni si më të përshtatshme dhe efektive për të ofruar ndihmë për fëmijët e abuzuar brenda rrethit të besimit dhe prindërit e tyre jo-abuzues?
2. Sipas mendimit tuaj, a duhet që të përfshihet në legjislacionin tonë limiti kohor për rastet e fëmijëve të abuzuar?
3. A jeni në dijeni për ligjin mbi raportimin e detyrueshëm të rasteve me ASF? A mendoni se përgjithësisht ky ligj zbatohet?
4. Sipas mendimit tuaj, cila është përqindja e raportimeve false (të rreme) të bëra nga fëmijët dhe adoleshentët ndaj personave brenda rrethit të tyre të besimit në rastet e ASF?
5. Sipas mendimit tuaj, cila është përqindja e rasteve të ASF brenda rrethit të besimit që raportohen në rastet e divorceve konfliktuale?
6. Sa përqind të rasteve të ASF mendoni se ndodhin brenda rrethit të besimit të fëmijës së abuzuar?
7. Sipas mendimit tuaj, a mundet që raportimet për ASF brenda rrethit të besimit të jenë rezultat i sugjerimeve apo ndikimit të një të afërmi tjetër, i rritur apo fëmijë?
8. Sipas mendimit tuaj, a i harrojnë viktimat e ASF përvojat e tyre traumatike? A mund ta kujtojnë ato përvojën e tyre edhe pas një periudhe harrese?
9. Sipas mendimit tuaj, a ka burime të mjaftueshme dhe efektive në vendin tonë për të ofruar shërbime dhe mbrojtje për fëmijët viktimë të ASF në rrethin e tyre të besimit, dhe për prindërit e tyre jo-abuzues?



TEMA 4: Mbyllja (10 min.)

1. Në përgjithësi, cili është opinioni juaj personal mbi gjendjen e tanishme të sistemit lidhur me mbrojtjen e fëmijëve të abuzuar seksualisht?
2. Cilat janë sugjerimet apo rekomandimet tuaja kryesore për përmirësimin e situatës?

Protokolli i Fokus Grupeve me të Rinjtë që në Fëmijëri Kanë Qenë Viktima të Dhunës Seksuale në Rrethin e Besimit

Dhuna ndaj fëmijëve përfshin të gjitha format e keq-trajtimit fizik, psiko-emocional, abuzimin seksual, neglizhencën, apo shfrytëzimin e fëmijëve – duke shkaktuar në këtë mënyrë dëmtime të gjendjes shëndetësore të fëmijëve, pengesa në zhvillim, si dhe humbjen e dinjitetit.

Në veçanti, **abuzimi seksual** i fëmijëve nënkupton përfshirjen e fëmijëve në aktivitete seksuale të cilat ato nuk i kuptojnë plotësisht, ose nuk janë të përgatitur apo të zhvilluar (të rritur) prandaj edhe janë të paaftë që të japin miratimin/pëlqimin përkatës, ose aktivitete të cilat bien ndesh me ligjet dhe tabútë e shoqërisë.

Dhuna seksuale ndaj fëmijëve evidentohet nga aktivitete të tilla mes fëmijës dhe një personi të rritur, ose një tjetër fëmijë më të rritur i cili ka marrëdhënie besimi, apo pushteti (autoriteti) me fëmijën e dhunuar.

Aktivitete të tilla të lidhura me abuzimin seksual të fëmijëve mund të përfshijnë situatat e mëposhtme (listë e cila nuk është aspak shteruese):

- Përfshirja e fëmijëve në aktivitete seksuale të paligjshme;
- Shfrytëzimi i fëmijëve për prostitucion, ose praktika të tjera të paligjshme;
- Shfrytëzimi i fëmijëve për performanca të ndryshme pornografike.

Abuzimi seksual i fëmijëve në "rrethin e besimit" i referohet dhunimit seksual të fëmijëve nga një ose disa persona të njohur dhe të besuar të cilët kanë autoritet dhe influencë tek fëmijët, përfshi këtu edhe personat brenda familjes së ngushtë.



TEMA 1: Kuadri i përgjithshëm i studimit (10 min.)

Ndërkohë që përgatiten, moderatori duhet t'i drejtojë pjesëmarrësve pyetjet e mëposhtme:

1. Sipas mendimit tuaj, a janë shërbimet e mjaftueshme dhe efektive (të përshtatshme) për adresimin e ASF brenda rrethit të besimit të fëmijëve të abuzuar?
2. Sipas mendimit tuaj, cilat janë kufizimet apo dobësitë (dështimet) kryesore në funksionimin e përgjithshëm të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve?



TEMA 2: Funksionimi i procedurave ekzistuese dhe përshtatshmëria e shërbimeve ekzistuese (60 min.)

1. Sipas përvojës suaj personale, si i vlerësoni shërbimet shëndetësore për adresimin e ASF brenda rrethit të besimit të fëmijëve të abuzuar?
2. A mendoni se shërbimet shëndetësore janë të mjaftueshme dhe efektive (të përshtatshme)?
3. Sipas përvojës suaj personale, si i vlerësoni shërbimet sociale për adresimin e ASF brenda rrethit të besimit të fëmijëve të abuzuar?
4. A mendoni se shërbimet sociale janë të mjaftueshme dhe efektive (të përshtatshme)?
5. Sipas përvojës suaj personale, si do ta vlerësonit nivelin e ndërgjegjësimit, pikëpamjet dhe aftësitë e personelit arsimor në Shqipëri për identifikimin, pranimin dhe menaxhimin e raportimeve për ASF brenda rrethit të besimit të fëmijëve të abuzuar?
6. Cilin sektor apo shërbim e konsideroni si më të përshtatshmin në situatën e tanishme të shërbimeve?
7. Kur vendosët të flisnit për herë të parë mbi përvojën/situatën tuaj, a e dinit se tek cila agjenci apo tek cili shërbim duhet të drejtoheshit? Tek cili i rritur patët besim që do të mbështeste këtë që po bënit/këtë proces?
8. Tek cila agjenci/shërbim u drejtuat fillimisht?

9. A e ruajti konfidencialitetin kjo agjenci/institucion të cilit ju drejtuat fillimisht?
10. Gjatë trajtimit të rastit në të cilin ishit i/e përfshirë, a ishte e vështirë për ju të përballeshit me procedurat e nevojshme? Cilat ishin vështirësitë?
11. Gjatë trajtimit të rastit në të cilin ishit i/e përfshirë, cili shërbim apo sektor ju ndihmoi më shumë?
12. Gjatë trajtimit të rastit në të cilin ishit i/e përfshirë, cili shërbim apo sektor ju ndihmoi më pak?



